Somewhere Near My House

If I could only turn back and look
For the footprints left behind
long long time ago,
And the lost days of no return
Of the moments of being young,
Madly in love…
Have we made a mistake
Often I wonder!!!

Just like a breeze
The years passed us by
The sunset came to past…
Somewhere near my house
When everything ended…

Somewhere near my house
Without us
The days pass us by empty,
And dawn always comes
With the memory of you
Somewhere near my house

Lyrics by Uran R. Bajrami
Translated by Shqipe Malushi

ISBN 978-9951-419-30-7

FERID SELIMI / JONUZ FETAHAJ • PELLGU I DHEMBJES

FERID SELIMI / JONUZ FETAHAJ

PELLGU I DHEMBJES

Monografi për Uran Bajramin



Prishtinë, 2009

FERID SELIMI
JONUZ FETAHAJ

PELLGU I DHEMBJES
(Monografi për Uran Bajramin)

Botues:
VATRA

Ballinën e punoi:
Shkodran Islami

Prapa në ballinë:

Bendi "Babilon"
Nga e majta, në këmbë: Besim Hajdini (në të zeza) solo-kitarist, **Uran Bajrami** (në mes) - Bass kitarist, **B. B. Poqi** (me xhemper) - vokal
Ulur: **Mentor Haziri** - timpanist.

FERID SELIMI
JONUZ FETAHAJ

PELLGU I DHEMBJES

(Monografi për Uran Bajramin, anëtarin e Bendit "Babilon")

VATRA
Prishtinë
2009

Në vend të parathënies

Monografia "Pellgu i dhembjes" kushtuar Uran Bajramit, njërit ndër rokerët më të rinj kosovarë e, që tani më e keni në duar, përbën një strumbullar krejt të veçantë të jetës dhe veprës së tij, si krijues letrar dhe si bass kitarist në bendin Babilon. U nda në moshën 21 vjeçare tragjikisht nga jeta, duke e përjetësuar emrin e vet, përkatësisht duke lënë prapa tekste të këngëve që edhe sot e kësaj dite kanë mbetur hite.

Të shkruara, këtu e njëzet e pesë vjet më parë dhe të kompozuara po ashtu në atë kohë, assesi t'i mbulojë pluhuri i harresës, siç ndodh me disa këngë e këngëtarë të tjerë. Kjo mbase bëri që Urani, gjithnjë të jetë në mendjet e miqve, të dashamirëve dhe të adhuruesve të Rok muzikës, që kultivohej viteve të tetëdhjeta në Kosovë.

Për të përpiluar këtë monografi, na ndihmoi shumë babai i Uranit, z. Raif Bajrami, si dhe miqtë e tij të fëmijërisë, Bajram Bylykbashi – Poqi e Besim Hajdini, të cilët nuk hezituan për asnjë moment për të na ofruar gjithë ndihmesën e duhur, si në grumbullimin e materialit, ashtu edhe në të kontaktuarit me shokët e tjerë të fëmijërisë. Monografia përmban sekuenca intervistash të kohës,

biseda të rastit, kujtime, fotografi, shkrime të gazetave, krijime të Uranit, krijime kushtuar atij, vështrime për poezitë e shkruara nga ai, si dhe përkujtime.

E veçanta e krejt kësaj që e thamë më lart, qëndron në atë, që gjetëm gjatë përpilimit të Monografisë. Ishin dy fletore të ruajtura me xhelozi nga miku i tij i fëmijërisë dhe shoku i klasës, Besim Hajdini. Kjo na e lehtësoi sado pak punën dhe e shtoi numrin e krijimeve të tij autoriale.

Gjatë përpilimit të monografisë kemi shfrytëzuar të gjitha burimet e mundshme që u gjetën e që kishin të bënin me jetën dhe me krijimet e Uran Bajramit. Megjithatë, jemi të vetëdijshëm për ndonjë lëshim, sepse, është e pa mundur të thuhen të gjitha në kornizat e një monografie të tillë.

Le të mbetet detyrë e gjeneratave që vijnë, të hulumtojnë e të shkruajnë më tepër, për të.

Autorët

BIOGRAFIA E URAN BAJRAMIT

Uran Bajrami, u lind në Preshevë më 20 dhjetor 1968. Ishte fëmija i parë i familjes Bajrami. I ati Raifi, ishte arsimtar i matematikës, që më vonë u diplomua në Fakultetin Juridik në Prishtinë. Një mandat ishte drejtor në Shkollën Fillore "15 Nëntori" në Preshevë (tani SHF "Ibrahim Kelmendi", vërejtje e autorëve) për të vazhduar më tej punën në Fakultetin Filozofik, në Universitetin e Prishtinës, në cilësinë e sekretarit.

E ëma Qamilja, si mësuese e angazhuar në ciklin klasor, një jetë të tërë ia kushtoi arsimit, duke mësuar dhe edukuar gjenerata të shumta të nxënësve.

Urani, në Preshevë, në qytetin e tij të lindjes, arriti që vetëm klasën e parë ta mbarojë, sepse pas përfundimit të vitit shkollor, familja e tij u shpërngul në Prishtinë.

Shkollimin e mëtutjeshëm fillor që nga klasa e dytë e deri në të katërtën e vazhdoi në Shkollën Fillore "Naim Frashëri", për të ndërruar sërish ambientin shkollor që nga klasa e pestë, kur kaloi në Shkollën Fillore "Ismail Qemali" në Prishtinë. Pas mbarimit të fillores, u regjistrua në QAMO (tani Shkolla e Mesme Teknike, në Prishtinë), ku i kreu dy vitet e para të mësimit të orientuar, për të vazhduar

dhe për t'i kryer dy vitet e tjera në Shkollën e Mesme Ekonomike, me sukses shembullor.

Urani fotografuar në dhomën e ditës

Më tej u regjistrua në Fakultetin Ekonomik. Vitin e parë e kreu me sukses, duke kryer të gjitha provimet. Derisa pritej të fillonte viti i dytë

akademik, në një aksident komunikacioni, humbi jetën tragjikisht diku në afërsi të qytetit të Nishit (në Serbi), derisa kthehej nga Bullgaria, ku kishte udhëtuar për të blerë një kitarë elektrike, për të qenë më në trend në bendin e tyre.

Si i vogël vërehej interesimi për lexim dhe muzikë. Meqë në atë kohë ishte në trend muzika rok, heavy-metal, ai iu përkushtua këtij zhanri të muzikës.

I inspiruar nga leximi i librave filozofik dhe historik (sepse qysh fëmijë kishte lexuar mbi civilizimin e lashtë të Babilonisë, pastaj ato që kishin të bënin me parapsikologji dhe filozofi si: "Kështu fliste Zaratustra" etj.) filloi të bëj hapat e parë edhe në artin e të shkruarit.

Me shokët e tij të fëmijërisë: B. B. Poqin dhe Besim Hajdinin, vendosin të formojnë një grup muzikor, meqë që të tretë e donin kitarën dhe kishin filluar të ekzekutonin tingujt e parë të rokut. Kështu në vitin 1984 formohet grupi muzikor "Babilon" kumbar i të cilit bëhet vetë ai, dhe meqë kishte filluar të merrej edhe me poezi, tekstin e parë e shfrytëzon për këngë të parë. Meqë poezia titullohej "Babilon", edhe grupin e emërtojnë me të njëjtin emër.

Kjo këngë incizohet në Radio Prishtinë me producent Tomor Berishën e incizues Ilir Hoxhën. Me këtë këngë fillon historiku i këtij Bendi që më vonë do të bëhet i njohur edhe me këngët e tjera që do t'i shkruaj Urani, do t'i kompozojnë Besimi, për t'i kënduar Poqi. Ushtrimet, para incizimeve të

këngëve, para koncerteve dhe të festivaleve, në mungesë të lokalit, i bënin nëpër shtëpitë e tyre, herë te Urani, herë te Besimi e herë te B. B. Poqi. Por, meqë në shtëpinë e Uranit kishte garazh, pjesën dërrmuese të ushtrimeve i mbanin në këtë vend.

Kur Bendi Babilon kishte filluar të frymojë si Rok grup tani i njohur në Kosovë, me paraqitjet e tyre serioze që premtonin një muzikë avangarde dhe kur kishte shkruar edhe tekstin e këngës së ardhshme të titulluar "Diku në afërsi të shtëpisë sime", niset për në Bullgari për të blerë një kitarë elektrike, sepse kitara që e kishte (e firmës së njohur Melodia) nuk i plotësonte nevojat e duhura.

Në kthim e sipër, në afërsi të qytetit të Nishit, veturën e tipit "Lada" që e ngiste shoku i tij i lagjes, Pajtim Kapiti, e shtyp një autobus për t'i lënë të vdekur: Uranin, Pajtimin dhe Meritën. Ishte kjo dita e 30 shtatorit e vitit 1989. Dita më e zymtë e qytetit të Prishtinës. Dita më e zymtë e Rokut kosovar të asaj kohe. Urani jo që nuk e blen dot kitarën, por, ikën tinëzisht e përgjithmonë në përjetësi, për t'i lënë prindërve: Raifit e Qamiles, motrave: Venerës e Donikës, vëllait Lavonit, miqve: B.B. Poqit, Besimit, Mentorit, Arbenit, Dritonit, Arbërit, Ardianit, etj.- *pellgun e dhembjes*. Këtë pellg të dhembjes, këta, asnjëherë nuk do të mund ta tejkalojnë.

Rastësia – thonë - është mbret i botës. Uran Bajrami, foshnje (në moshën tetëmuajshe), rastësisht me familje e bën udhëtimin e parë për në Bullgari.

Njëzet vjet më vonë, po gjatë kthimit nga ky shtet, humb jetën tragjikisht.

Gjatë krejt jetës së tij 21 vjeçare, la katër tekste këngësh (që edhe sot e kësaj dite këndohen dhe janë përfshirë në këtë monografi) disa poezi të pabotuara dhe dy proza të shkurtëra e që disa prej tyre i gjetëm të shkruara në origjinal.

Në një fletore që shoku i tij i lagjes, i fëmijërisë, i klasës, e më vonë edhe i Bendit, Besim Hajdini, ia kishte ruajtur me xhelozi. Urani, në atë fletore i kishte shkruar vjershat, mbase versionin e parë të tyre, andaj i botuam ashtu si i ka shkruar ai, pa asnjë ndërhyrje. Ndërsa një fletore tjetër, që Urani kishte lënë në shtëpi, ishte tretur diku aksidentalisht.

I ati i tij, Raifi, pas vdekjes së të birit, e kishte gjetur fletoren në fjalë, e kishte ruajtur deri para sa kohësh, por për fat të keq, gjatë një pastrimi rutinë të shtëpisë, fletorja humb pa shenj e pa dok.

I kujtohet z. Raifit, vetëm një poezi e gjatë, e titulluar "Baladë për..." që Urani i kishte kushtuar një vajze që kishte simpatizuar gjatë moshës adoleshente. Për fatin tonë dhe tuajin, kjo vjershë që i kujtohej të atit të tij, u gjet në fletoren e lënë te miku i tij Besimi, dhe kjo poezi është sistemuar në këtë Monografi.

Lexues të nderuar, fletorja e mbushur me vjersha të tjera që Urani kishte lënë në shtëpi, nuk ekziston më. Apo, mbase është diku e strukur në ndonjë sirtar.

Të shpresojmë të jetë kështu.

Mbase, ndonjëherë, dikush do ta gjej, ashtu rastësisht, siç ishin edhe udhëtimi i parë dhe i fundit i tij, për në Bullgari.

NJË HISTORIK I SHKURTËR I BENDIT BABILON

Rok-grupi "Babilon" gjatë një performimi në vitin 1987. Nga e majta Mentor Haziri - Keksi (timpanist), Besim Hajdini (solo kitarist), Uran Bajrami (bass-kitarist) dhe B. B. Poqi (solist)

Ansambli Vokalo-instrumental (Bendi) Babilon formohet në vitin 1984, me iniciativë të Uran Bajramit, Bajram Bylykbashit – Poqit e Besim Hajdinit. Kumbar i emërtimit të Bendit ishte Urani, meqë, kishte shkruar tekstin e parë me po të njëjtin titull që e kishin incizuar si këngë të parë të tyren në vitin 1985 në Radio Prishtinë. Sipas, B.B. Poqit, solistit të këtij Bendi, dilemë nuk kishte pasur rreth

emërtimit, sepse vetë Urani e kishte gjetur dhe këta ishin pajtuar.

Urani, (Bass kitarist) Poqi, (solist dhe kitarist) dhe Besimi (kitarist) ishin tre themeluesit dhe anëtarët e rregullt të Bendit Babilon. Ndërkaq anëtari i katërt (timpanisti) Mentor Haziri, njëkohësisht ishte anëtar i këtij Bendi dhe i një Bendi tjetër. Mirëpo, sa herë që është dashur të incizojnë ndonjë këngë, ose të paraqiten në ndonjë koncert, Mentori ishte pjesë e Bendit.

Gjatë kohës sa ekzistoi Bendi (1989) Urani ishte tekstshkrues i këngëve që u bënë hite të kohës, por që vazhdojnë të këndohen edhe më tutje nga Bendet e sotme dhe dëgjohen nga adhuruesit e muzikës Havi metal.

Vdekja tragjike e Uran Bajramit, njërit nga themeluesit e këtij Bendi, ishte edhe shkak për shpërndarjen e tij.

B.B. Poqi, solist dhe kitarist i këtij Bendi të njohur, jeton dhe vepron në Prishtinë (shpesh paraqitet nëpër koncerte e mbrëmje muzikore). Ka edituar këngë të reja, këndon solo, por duket që ende nuk e ka tejkaluar vdekjen e mikut të fëmijërisë dhe të rinisë, Uran Bajramit.

Besim Hajdini jeton dhe punon në Angli.

Ndërsa **Mentor Haziri**, jeton në Prishtinë.

Gjatë kohës sa ekzistoi Bendi, mori pjesë në shumë koncerte (para grupe) dhe festivale të ndryshme. Disa herë ishin pjesëmarrës të rok festivalit "Boom" që organizohej aso kohe në

Prishtinë, si dhe në kitariadë. Këngët më të njohura të këtij Bendi janë: ***Babilon, Ti je vetëm një iluzion, Edhe një natë si kjo***, dhe ***Diku në afërsi të shtëpisë sime***.

Që të gjitha këto këngë janë shkruar nga Uran Bajrami e janë kompozuar nga B.B. Poqi dhe Besim Hajdini.

Pamje nga koncerti i Bendit "Babilon"

PËR URANIN FOLËN...

Bajram Bylykbashi - Poqi

TAKIMI ME B. B. POQIN NË KAFENENË "TE KANDI" NË ULPIANË

Sot derisa bisedojmë dhe përkujtojmë ditët e rinisë dhe të adoleshencës, B. B. Poqi, njëri nga anëtarët e Bendit të njohur kosovar "Babilon" dhe mik i ngushtë i Uran Bajramit, shpalos në detaje angazhimin e tyre për të krijuar këngë dhe për t'u bërë të njohur në skenën kosovare. "*Në kohën e adoleshencës, duke dëgjuar muzikë të kohës, na lindi ideja, motivi për të filluar me muzikë të kohës, për t'i treguar botës se edhe ne dimë të bëjmë muzikë Rok.* – shprehet Poqi. - *Ideator i grupit dhe kumbar ishte Urani. Së pari filluam t'i bimë kitarës akustike që e kish blerë Urani. Më pas Uranit i blen babai një kitarë elektrike të markës "Melodia", me të cilën Urani performoi, derisa nuk u shpërngul në amshim...*

Kishim ide të njëjta, vizione të njëjta, ëndrra të njëjta

Biseda rridhte qetë e koha kalonte pahetueshëm, derisa në fytyrat e Poqit dhe të z. Raifit, (i ati i Uranit) vëreheshin dhe shfaqeshin emocione që edhe përkundër dëshirës për t'i fshehur, assesi t'i mundnin ato.

Gjatë bashkëbisedimit, nuk mund të anashkalohej e të mos përballeshin, e sidomos B. B. Poqi, edhe kësaj here si edhe herëve të tjera me një sfidë, mbase që ky i fundit, kurrë s'e kishte tejkaluar. Çfarë e ndjek prapa. Pse asnjëherë s'e harron mikun e tij të fëmijërisë, Uran Bajramin.

Shtator 1987, nga e majta: Denis Rashiti (humbi jetën tragjikisht më 1992), Besim Hajdini, Uran Bajrami, B. B. Poqi, Kastrioti, Dugi, Ylberi dhe Arsimi

Pyetja ishte e gatshme. Nuk kishim çfarë të përpilonim aty për aty. Poqi, në të gjitha paraqitjet e tija publike përmend Uranin (njërin nga anëtarët e Bendit Babilon) dhe nuk kishte sesi t'i ikte kësaj pyetje: ç'është ajo që e shtyn ta përmend gjithmonë, për pa e harruar asnjëherë. Bile kjo vërehet edhe te

manifestimet dhe përkujtimet për të (ky ishte një ndër më aktivët). Padyshim që do të mund të thoshte më tepër për këtë fenomen që e ndjek si hije.

E ai nuk heziton fare dhe ashtu pa u hamendur fillon përgjigjen që e mbarte me vete kah do që shkonte.

Arsyeja - thotë ai - *është shumë e thjeshtë... kemi pas shoqëri të sinqertë, pa dallavere. Jemi përshtatë në çdo aspekt, duke u nis prej ndikimit në muzikë, me ide të njëjta, vizione të njëjta, ëndrra të njëjta… kështu që vdekja e tij e parakohshme ka lënë një vërragë të pashlyeshme te unë... pardje kam qenë me të... të nesërmen iku... kjo është arsyeja që është i paharrueshëm për mua.*

S'ka sesi të mos besojë njeriu sinqeritetin e tij. Çdo fjalë e tij është kuptimplote dhe bindëse. Në kafenenë "Te Kandi" në Ulpianë, në praninë e prindit të Uran Bajramit, z. Raif Bajrami, B. B. Poqi sikur t'i ketë ruajtur në ditarin e jetës të gjitha kujtimet, të cilave duket që u kishte ardhur koha për t'i shpalosur.

Fjalët që duhet thënë për mikun e fëmijërisë dhe të rinisë, Uranin, i ishin ngulitur thellë në mendje dhe kujtesë

Herë-herë, si B. B. Poqin ashtu edhe të atin e Uranit i tradhtonin ndjenjat dhe emocionet. Sytë e tyre mbusheshin lot e duke dashur të fshihnin "hajninë e tyre" e bënte paloma e bardhë, që, dorën

në zemër, na bëhej se flitej vetëm për bardhësinë dhe përjetësinë, por edhe për zjarrin dhe zogun e kujtimit – Feniksin i cili edhe në këto emocione çasti sjell një udhëtim nëpër kohë në maratonën e kujtimeve. Por, edhe loti e, ndoshta edhe ndonjë ofshamë apo edhe "heshtje e kallur" siç do të shkruaj bardi i poezisë sonë Din Mehmeti, e arsyetojnë edhe lojën e tymit të duhanit dhe ndonjë gëllënkë harrim...

Në të vërtetë, ishte kujtimi për Uranin, që si B. B. Poqi, ashtu edhe ne që, ishim të pranishëm, në tavolinën e vogël, dukej se, as pas njëzet viteve nuk e kishim tejkaluar me një shtresë pluhuri harrese...

Padashur dhe pa imponime, vjen momenti kur B. B. Poqi eksplodon me fjalë dhe me kujtime. Në një rast më dukej që lexonte intervistën e tij, dhënë 14 vjet më parë gazetës së studentëve "**Bota e re**". Atë intervistë e kishim lexuar dhe të themi të drejtën befasoheshim me fjalët që thoshte Poqi. Në një moment ai shprehet:

Në moshën 15 vjeçare (1984) së bashku me shokët e fëmijërisë Besim Hajdinin, Uran Bajramin dhe Mentor Hazirin, formuam grupin "Babilon" për të bërë pas një viti incizimin e parë. Ishte kjo këngа "Babilon" e kompozuar nga unë për të vazhduar me këngët "Ti je vetëm një iluzion", "Edhe një natë si kjo". Të tri këto këngë do të bëheshin hite të vërteta.

...Dhe derisa bisedojmë, nuk është e tepërt, duket që B. B. Poqi, fjalët që duhet thënë për mikun e tij të fëmijërisë dhe të rinisë, Uranin, i kishte ngulitur thellë në tru dhe sa herë duhej, i nxirrte ato pa

ndonjë problem dhe thua që i ka të ndiera dhe të incizuara dje, apo edhe mbrëmë...

Prandaj, ne po i paraqesim fjalët e intervistës së tij dhënë kësaj gazete. Sepse edhe fjalët janë krejtësisht identike. Më poshtë, duke shpaluar punën dhe suksesin e tyre si grup muzikor, thotë edhe këtë:

Momenti më tragjik për mua, ishte vdekja tragjike e Uranit. Simbolikë e posaçme paraqet kënga e fundit e këtij grupi "Diku pranë shtëpisë sime", tekstin e së cilës e kishte shkruar i ndjeri, i cili siç duket e kishte parandie vdekjen. Vdekja e Uranit dhe emigrimi i anëtarëve të tjerë të grupit solli edhe pushimin e aktivitetit të "Babilon" -it.

Vdekja e Uranit – thotë Poqi, ishte vdekje klinike e Bendit "Babilon"

Derisa përshfaq momente e dromca të jetës krijuese, ia përkujtojmë B.B. Poqit, intervistën dhënë gazetës "Bota e re" e ai pa hezitim e nxjerr nga xhepi atë faqe të gazetës, të cilën e kishte marrë me vete, e së bashku lexuam:

Moment tjetër i veçantë ishte mbyllja e RTP, si dhe Produksionit të kasetave, në prag të editimit të kasetës së parë, e cila do t'i kushtohej shokut të ndjerë – Uranit.[1]

E Poqi nuk ndalet vetëm me kaq.

---

[1] Intervistë e B.B. Poqit dhënë gazetës së studentëve "Bota e re", nëntor 1995

Na shfleton gazetat ku ai është paraqitur nëpër intervista të ndryshme. Dhe kudo, ama në secilën intervistë, nuk harron të përmend Uranin dhe vdekjen e tij tragjike. Sepse, vdekja e Uranit – siç shprehet edhe vetë Poqi, ishte edhe vdekje klinike e Bendit "Babilon".


për përmbajtjen e filmit për të cilin po flitet shumë kohëve të fundit?

- Në film frajtohet jeta dhe veprimtaria e grupit Babilon prej hapave të parë te këtij grupi e deri te vdekja e artistit të grupit Uran Bajramit. Ngjarja është e vërtetë, por e realizuar në rrethana dhe në vend tjetër. Filmi është i metrazhit të shkurtër dhe zgjat rreth 12 min. Filmi mban titullin "Somewhere near my house" që është përkthim i titullit të këngës "Diku pranë shtëpisë sime", tekstin e tij e ka shkruar vetë Urani. Regjisor, skenarist, producent dhe aktor në film është Agim F. Gërbeshi, i cili ka mbaruar Akademinë e regjisë në Nju-Jork.

I shfletojmë gazetat një nga një: "Bota e re". Nëntor 1995; "Okarina" nuk i shihet muaji as viti i botimit, por ne gjithsesi do ta japim në faksimil. Po ashtu "Pulsi" pa muaj as vit botimi. "Kosovarja" dhjetor 1997. "Zëri i Rinisë" 27. 12.1997. Dhe maja e krejt këtyre arrin kur na hedh përpara versionin origjinal të këngës "Ti ishe vetëm një iluzion" shkruar nga dora e Uran Bajramit, e që strofa e fundit nuk duket ngase është shqyer letra; si dhe fotografinë e vitit 1987 e grupit "Babilon" fotografuar në Festivalin e Rok-muzikës "Boom 1987".

Të dyja këto dokumente ishin ruajtur me xhelozi nga B. B. Poqi, por shiheshin që ishin

dëmtuar paksa. Sidoqoftë, këto materiale po i paraqesim si të tilla në këtë monografi.

Besim Hajdini (solo-kitarist i rok-grupit "Babilon")

(Bisedë e zhvilluar nëpërmjet internetit me Besim Hajdinin – anëtar i rok-grupit "Babilon" dhe shok i ngushtë i Uranit, që nga fëmijëria, e që momentalisht jeton dhe punon në Londër të Anglisë)

Thamë: në qoftë se duam të bëjmë zhurmë, do të bëjmë...

Miku tjetër i fëmijërisë dhe anëtari i Bendit "Babilon", Besim Hajdini, me të cilin kontaktuam me ndihmën e B.B. Poqit, pasi i shkruam një letër në adresën e tij elektronike, sepse me vite të tëra gjendet në Angli, nuk ngurroi fare që të na kthejë letrën dhe të na dërgojë një mesazh urimi.

Jo vetëm kaq.

Nuk ngurroi fare as të na dalë në ndihmë. Kështu, pos që kishte shkruar një letër motivuese, ku kishte derdhur tërë ndjenjat dhe emocionet e tij, për kohën e kaluar bashkë me Uranin, na ndihmoi edhe me disa fotografi të fëmijërisë, të rinisë si dhe të grupit "Babilon", fotografi këto, ku shihet edhe Urani.

Më pas na siguron të ketë ruajtur një fletore të formatit A4, ku Urani do të mund të kishte edhe disa krijime e shënime të tjera...

Ja si shprehet Besimi, kur e pyesim si u njoh me Uranin, kur filloi të shoqërohej me të, çfarë në të vërtetë ishte dhe si sillej me miqtë e tij:

"*Unë Uranin* – shkruan Besimi në këtë letër interneti - *e kam takuar në fëmijëri. E kisha shok klase dhe kemi jetuar shumë afër njëri-tjetrit. I patëm përgatit disa këngë me kitarë akustike dhe ishim shumë afër për t'i incizuar në Radio Prishtinë. Përnjëherë ndërruam mendje dhe para neve u shfaq një dilemë: në qoftë se duam të bëjmë zhurmë, do të bëjmë zhurmë SHUMË, me kitara elektrike, kështu që u përcaktuam dhe vendosëm që të pushojmë një kohë.*

Urani me shokët e shoqet e klasës së shtatë, fotografuar para SHF. "Ismail Qemali" në Prishtinë

Ditën flinim, ndërsa natën dëgjonim muzikë dhe i binim kitarës

Kemi përjetuar shumëçka bashkë: gëzime, probleme, fillimin – gëzimin e dashurisë së parë, fundin – hidhërimet e dashurisë së parë... ndërmjet veti nuk kemi pasur sekrete. Prindërit e Uranit, gati tërë verën e kalonin në Preshevë, e ne të dy rrinim "**me rujt shpinë".** Flinim tërë ditën, ndërsa natën rrinim, duke dëgjuar: Scorpions, Pink Floyd, Dire Straits, Deep Purple, Whitesnake, duke i ra kitarës e duke ëndërruar...

Në një prej këtyre mbrëmjeve të shumta, e patëm vendos që t'i kushtojmë një këngë një vajze që Uranit i pëlqente shumë. Ka pasur të drejtë Urani, sepse, ajo njëmend ishte një "**something special**"...

Uranit i pëlqente të shkruante tekste

Në fillim u patëm izoluar pak, duke ndenjur natën e duke mos kontaktuar me njerëz të tjerë. Kështu e patëm formuar një lidhje/shoqëri të fortë. Rastësisht iu bashkëngjita një grupi (përkohësisht) dhe për një kohë të shkurtër i patëm ndërprerë planet e muzikës me Uranin. Mirëpo, pas një kohe, dola prej atij grupi.

Urani kishte biseduar me Poqin për ta formuar një grup dhe e kishin bërë një këngë. Më njoftuan për këtë ide të tyren dhe meqë njihesha mirë edhe me

Poqin, u pajtova me atë ide dhe iu bashkëngjita menjëherë.

Besim Hajdini (në këmbë) me Uranin (ulur)

Uranit i pëlqente të shkruante tekste e nuk kishte interesim për të kompozuar. Ndërsa, mua më pëlqente e kundërta (Poqi ka dhënë kontribute në të

dy anët, sipas nevojës), kështu që krejt çka kemi bërë ishte punë jona dhe e kemi çmuar si diçka personale.

Nuk kemi dashur që menjëherë të incizonim krejt çka na pëlqente, sepse ishte herët. Kemi menduar të provojmë me disa këngë dhe të shihnim se ku ishim dhe si do t'i pranonte publiku, të bëjmë emër dhe të përfitojmë pak përkrahje, për t'i hapur disa dyer të tjera.

Fati nganjëherë ta kthen shpinën...

Atë që e kishim menduar ose që kishim vendosur t'i kushtojmë një këngë asaj vajze që Urani e dashuronte, tanimë ishte bërë realitet. Ai e bëri tekstin e këngës. Nuk e di pse, por Urani të shumtën e kohës i kushtoi asaj kënge, ndërsa nuk ndërmerrte diçka më shumë, më konkrete. Unë e di që edhe asaj i ka pëlqyer Urani, por fati nganjëherë ta kthen shpinën, kështu që ata dy asnjëherë nuk arritën të kurorëzojnë ëndrrat adoloshente... Ajo tash ka formuar një familje shumë të mirë dhe i takoj nganjëherë kur vi në Prishtinë (rrallë). Asnjëherë nuk e kam takuar vetëm për vetëm dhe nuk m'u ka dhënë rasti t'i tregoj, por, shpresoj që do të vijë momenti i duhur, kur do t'i tregoj që ajo këngë është shkruar enkas për të.

Kontaktet i mbanim me letra

Urani ishte shumë i kujdesshëm. Para se të incizohej kënga, deshi t'i ndryshonte disa vargje, në mënyrë që shoqëria të mos e kuptonin për kë bëhej fjalë. Kënga është titulluar Iluzioni, dhe me të vërtetë, ajo vajzë, të cilës iu kushtua kënga, mbeti vetëm një iluzion.

Uran Bajrami, ushtar në Varazhdin të Kroacisë, 1988

Ne u patëm dëshpëruar pak me kualitetin e incizimit dhe për një kohë nuk kemi ditë kah t'ia mbajmë. Mbanim koncerte të vogla në Prishtinë, sidomos në platonë e Pallatit të Rinisë (përmbi sallën sportive, ish Boro e Ramizi).

Pas një kohe, Urani shkoi në ushtri në Varazhdin. Kontaktet i mbanim rregullisht me letra. Kur e kreu ushtrinë, për çudi edhe mua më dërguan mu në atë kazermë. Prapë i mbanim kontaktet me letra.

Anglezët e kanë një shprehje "**so near yet so far**", ashtu ndjeheshim në ushtri. Kur lexoje një letër prej një shoku, ndjeheshe shumë afër shtëpisë. Përndryshe, ndjeheshe i humbur. Gjatë asaj kohe e patëm bërë këngën "**Diku pranë shtëpisë sime**".

Nuk kalon ditë, pa menduar për të

Pasi u ktheva nga ushtria (15 shtator 1989) shkuam drejt në Radio Prishtinë, të caktonim një termin për të incizuar këngën. Terminin e caktuam pas dy javësh. Dy ditë para incizimit, e mora lajmin më të rëndë në jetë. Të ju them të drejtën, nuk kam ditur si të reagoj, më dukej e pabesueshme. Më dukej si film dhe pritja Uranin për t'i treguar...

Si i ri vetja të dukej "**untouchable**". Nuk mund të paramendosh që në atë moshë, dikush aq i afërt të largohej në atë mënyrë, përgjithmonë.

Urani ka lexuar shumë dhe ka qenë shumë më i ditur se moshatarët e tij. Ishte kënaqësi të rrish dhe të bisedoje me të. Ka lënë zbraztësi të madhe në shoqëri, muzikë, familje... Nuk kalon ditë, pa menduar për të. Shpesh mendoj: **a thua ku do të**

mund të ishim sot? Jam i vetëdijshëm që jeta ime private dhe ajo e muzikës do të ishin krejt të tjera.

Bekimi, Besimi dhe Urani

Ja edhe letra përcjellëse e Besimit. Mbase, kjo ishte maja e mjaltës.

P.S. *E kam një fletore A4 të Uranit. diku në shtëpi në Prishtinë, nëse doni ta huazoni, më tregoni dhe mund të shkoni ta merrni. Ka do tekste edhe sende për shkollë, që i ka shkruar Urani. Ndërkohë do t'i dërgoj edhe disa foto.*

Faleminderit, Besimi

Mentor Haziri (timpanist në rok grupin "Babilon")

RITMIN E KËNGËS E PËRCOLLËM ME BORI TË MAKINËS

Uranin e kujtoj më së shumti si shokun tim me të cilin kemi bërë muzikë së bashku me Poqin dhe me Besimin. Do ta kujtoj një prej ushtrimeve tona si grup, ushtrime këto që i bënim në shtëpinë e Uranit, përkatësisht në dhomën e ditës apo në garazh.

Ishim duke e ushtruar këngën "***Edhe një natë si kjo***".

Unë dhe Urani duhej ta ndalnim Besimin që kënga të mos shkonte me vijë ritmike aq të shpejtë, por Besimi si Besimi, i shpejt me gishtat e tij, ishte e vështirë për ta ndalur.

Me Uranin, vendosëm të shkonim poshtë në garazh dhe ritmin e këngës ta përcillnim me borinë e makinës së Z. Raifit. Ishte mjaft efekt i mirë, por në anën tjetër, shumë qesharake të stimulohet ritmi me bori.

Kur nuk bënim muzikë, luanim basket

Nëse nuk bënim muzikë, me Uranin luanim basket.

Derisa të gjithë ne të tjerët luanim një sport, Urani në çdo aspekt ishte më i gjithanshëm, edhe në

basket ka qenë tepër i mirë, sidomos në gjuajtjet nga distanca.

Asnjëherë nuk do t'i harroj dy momente.

Urani me shokët e klasës...

E para: kur kam kuptuar vdekjen e tij e që për shumicën prej neve nuk na dukej e vërtetë. Në fillim, nuk kam besuar që ka ndodh diçka e tillë, por fatkeqësisht ishte e vërtetë.

E dyta: fotografia e fundit nga varrimi i Uranit. Kur e vendosën arkivolin në rrugë dhe ne të gjithë e përshëndetëm për herë të fundit, nuk i harroj dot fjalët e fundit që Venera, motra e Uranit, ia tha vëllaut në ndarjen nga ai...

Driton Sahiti (i afërm i Uranit)

DIALOG ME TË BIJËN, KUSHTUAR URANIT

Driton Sahiti, një i afërm dhe shok i fëmijërisë i Uranit, pas një takimi që patëm në restoranin "Ambienti" në Prishtinë e ku ishin të pranishëm edhe Mentor Haziri, (ish anëtar i Bendit "Babilon") Arbër Skenderi (shok klase i Uranit), e Ardian Doko, (shok i fëmijërisë i Uranit) na premtoi që do të shkruaj diçka për ta inkorporuar në këtë Monografi. Ne pritnim, jo vetëm përgjigjen e tij, por edhe të shokëve të tjerë e sidomos të atyre treve që ishin në atë mbrëmje në lokal.

Pas dy-tre ditësh, na vjen përgjigja e Dritonit, përmes adresës elektronike. Shkrimi i Dritonit, në të vërtetë, siç na shpjegon edhe vetë ai, në letrën përcjellëse, është një akt drame që zhvillohet në dhomën e tij të punës, kur kishte filluar të shkruante diçka për Uranin. Papritur afrohet vajza e tij tetë vjeçare, Melisa, me të cilën doemos, zhvillon një dialog jo të zakonshëm. Melisa, nxënëse e klasës së tretë, nuk e njeh Uran Bajramin (krijuesin e teksteve, rokerin e "Babilon"-it, futbollistin, basketbollistin etj. por ama njeh një Uran tjetër, po të asaj shtëpie, ku Driton Sahiti dhe Uran Bajrami, (moshatarë) nja tridhjetë vjet më parë loznin nga oborri në oborr e nga rruga në rrugë…

Tani, pas njëzet viteve, Melisa ishte ajo që bridhte nga oborri në oborr me një Uran më të vogël (katër vjeçar). Uranin që i përtëriu emrin e protagonistit tonë.

"Më pate thënë: ka qenë shumë i talentuar…"

Këtë shkrim-dramë një aktshe, Dritoni e titullon: "***Dialog me të bijën, kushtuar Uranit***". Këtë dialog, për shkak të natyrës së Monografisë, do ta përfolim, por fillimin do ta paraqesim ashtu si është shkruar.

Ja si e fillon Dritoni këtë bisedë…

"....Duke u menduar çfarë dhe si të shkruaj për Uranin, e bija, Melisa, më pyeti: Çfarë kisha, pse qaja? Pse m'u kishin mbushur sytë lot...? E unë duke u munduar të arsyetoja veten, i thashë që po përpiqesha të shkruaja diçka, por, nuk dija nga t'ia filloja...

***Melisa**: E çka po shkruan ashtu babë..? pse t'u kanë mbushur sytë me lot?!!*

***Dritoni**: Paj,...ke të drejtë... mu kanë mbushur...sepse kujtoj Uranin...dhe mundohem të shkruaj diçka, sepse janë duke shkruar një libër për të.*

***Melisa**: Qysh Babë, për Uranin Libër?!! A s'është i vogël ai? (duke aluduar në Uranin e vogël, djalin e Lavonit)*

***Dritoni**: Jo Babë jo, (kështu i dretohet vajzës së vet Dritoni) për Uranin e Vogël, por të madhin,... të pata treguar njëherë më herët,... Axha Raif e ka pasur edhe një*

djalë e që ka vdekur i ri, në një ndeshje komunikacioni, para 20 vitesh...

***Melisa**: aha, po Babë, po, më kujtohet...më pate thënë që ka qenë shumë i mençur e talentuar…"*



Dritoni dhe Urani

Urani – thotë më tutje Dritoni – *ka lexuar shumë dhe ka ditur gjithçka e po ashtu ishte i talentuar për gjithçka. Prej fëmijërisë së tij që nga klasët e ulëta të shkollës fillore kishte filluar të lexonte jo vetëm lektyra, por edhe libra të tjerë. Mund të them që i ka lexuar mbi 1000 libra. Veçanti e tij ka qenë që ka mund të rrijë zgjuar deri në ora pesë e mëngjesit për të fjetur vetëm pesë apo gjashtë orë, deri në orën 11. Bile të tjerët kanë menduar që ai është gjumash, por jo... ai nuk ka qenë gjumash. Ka marrë pjesë në të gjitha garat shkollore dhe ka treguar rezultat të mirë.*

Nuk e harrojmë kujtimin për të...

Më kujtohet kur, pasi kishte shkruar një hartim për gjendjen e shqiptarëve, arsimtari i gjuhës shqipe kishte qarë. Pastaj ka shkruar poezi e tekste të këngëve...

Ka qenë muzicient, por mbi të gjitha: poet.

Ishte i mirë edhe në sport e sidomos në futboll, basketboll ping-pong e hendboll. Por futbolli i ka fjetur në shpirt. Ka pasur stilin e Zinedine Zidanit, sepse ka luajtur me të dy këmbët perfekt. Pa e prishur fare ka mundur t'i bjerë topit me kokë deri në 300 herë. Thjesht, ka qenë shumë i talentuar. Po ta miratonte axha Raif, mbase do të luante edhe për Partizanin e Beogradit, sepse kishim pasur një bisedë me një zyrtar të këtij klubi futbollistik. Shumë kohë kishim ndenjur bashkë: në shtëpi, në det, në Preshevë, në Kapit, etj. Bile pata shkuar edhe në Varazhdin (Urani shërbente ushtar) për ta vizituar.

Më pati premtuar që do të ma kthente vizitën. Ja në origjinal fjalët e tij: "***maje në mend, ku do që ki me shku ushtar, pa ardhë së paku njëherë me të pa, nuk e lo***" …por...ja... aq e kishte pasur.

Dritonin sërish e mundin emocionet. I lagen pak faqet, por ç'e do... Vazhdon rrëfimin për shoqërimin me Uranin. "*Rrinim bashkë, unë, Urani, Arbëri, Besimi, Ardiani, Bajrami, Iliri, Llusta. Ndërsa në Preshevë rrinim me Bufin, Halimin, Agimin...*

E, kur familjet tona udhëtonin për në Preshevë, ne të dy qëndronim në shtëpi, për t'i ftuar më vonë edhe shokët e tjerë. Kjo ishte koha kur shoqëroheshim me Uranin, por erdhi një ditë dhe më ai nuk ishte. Na la përgjithmonë. E ne nuk e harrojmë kujtimin për të..."

Agim F. Gërbeshi, regjisor

Agim F. Gërbeshi, regjisor shqiptar nga Prishtina që jeton dhe punon në New York të SHBA-së, i motivuar nga teksti dhe kënga e rok-grupit "Babilon" nga Prishtina, viteve të nëntëdhjeta bëri një film të titulluar me të njëjtin titull të këngës së shkruar nga Uran Bajrami dhe të ekzekutuar nga rok-grupi Babilon "Diku pranë shtëpisë sime". Ky film i metrazhit të shkurtër iu kushtua Uran Bajramit dhe rok-grupit "Babilon".

Filmi është incizuar në Amerikë dhe e tërë ngjarja është transferuar atje. Ne, kontaktuam me të, natyrisht nëpërmjet adresës elektronike, me të vetmin qëllim: të kuptojmë si i lindi ideja për të bërë film për këtë grup dhe mu për Uranin. Regjisori Gërbeshi, nuk u hamend fare, menjëherë pas pranimit të letrës që i dërguam, na ktheu këtë përgjigje:

Prishtina, qytet që krijon legjenda e nuk i vëren askush

Në video kasetën e koncertit të fundit të vëllait tim (Gipa-Ragipi) me grupin "Mesnata", në Prishtinë, para se të nisesha për në Shtetet e Bashkuara të Amerikës e shoh edhe Bajram Bylykbashin – Poqin, që ishte mysafir i mbrëmjes. Aso kohe isha student në NYU (Universitetin e

NewYork-ut) dhe rrugës për në ligjërata, në makinë me Gipin dëgjonim kasetën e grupit Babilon.

*Vargu i këngës "**O Babilon ëndrrat jetojnë gjithmonë...**", dhe tri këngë të tjera me tekste superiore, muzikë, aranzhman, solo-kitarë dhe këndim të shkëlqyeshëm. Shkurt, këngë superiore dhe po të ishin incizuar në gjuhën anglishte, sigurisht që do të ishin në top-listat me grupet më të mëdha të asaj kohe.*

*E pyes atë (Gipën) ku janë grupi "Babilon" që nuk kanë incizuar këngë të tjera? Ai bën një pauzë dhe më pas më rrëfen me keqardhje që Urani, në rrugë për në Bullgari (gjatë kthimit nga Bullgaria, v.a.) ku kishte shkuar për të blerë kitarë, pasi kishin bërë plane, që kur të kthehej të incizonin këngën **"Diku pranë shtëpisë sime"**. Gjatë kthimit nga ai udhëtim, bën ndeshje me makinë dhe vdes. Që nga ajo ditë, më grupi "Babilon" nuk ekziston.*

Teksti komplet si dhe kënga më përvetësuan dhe në imagjinatën time pashë Uranin me shokët e tij në Prishtinë. Në qytetin që krijon legjenda e nuk i vëren askush. Unë kisha fatin t'i dalloj i pari dhe me krenari u kam kushtuar filmin e parë.

Poqit, nuk i besonin që diku larg shtëpisë së tij, bëhej një film për të

Pasi vendosa të incizoj filmin për Uranin dhe për Babilonin, së pari, kontaktova Poqin dhe pasi bisedova me të, ngjarjen e transferova në USA, në rrugën New Jersey - New York.

Aty, paraqita grupin "Babilon" dhe takimin e tyre në "Studion 54" ku do të incizonin këngën që u kishte mbetur pa incizuar e që titullohej ***"Diku pranë shtëpisë sime"****, si dhe karakterin e Uranit, i cili në rrugë për në studio, në një tunel të New Yorkut, humb jetën tragjikisht me makinë.*

Derisa bëja montazhin e filmit në studio, në New York, erdhi Migjen Kelmendi, publicist, gazetar, e roker i grupit "Gjurmët". Ai u mahnit kur i tregova për filmin. Por, ajo që i bëri përshtypje ishte: kujdesi dhe ideja, që dikujt iu paska kujtuar të bëj film për një rok grup kosovar në Amerikë, e sidomos kur ai film i kushtohej Uranit.

Poqit, nuk i kishin besuar që diku larg shtëpisë së tij, bëhej një film për të, sepse, ishte koha kur ishte e pabesueshme dhe e pakuptueshme ideja që për një njeri të gjallë të bëhej film. Ishte nder i madh edhe për të, sepse për së gjalli do të shihte karakterin e vet në një film, e kur kjo

bëhej në Amerikë, dosido që ishte një punë për të cilën do të duhej të krenohej. Mu për këtë që e thashë më lart, deri në mbrëmjen e premierës, kur në Pallatin e Rinisë u tubuan me mija shikues për ta parë filmin, pjesa dërrmuese nuk e besonin.

Por, filmi ishte një realitet. Ndodhi.

Së shpejti, edhe versioni i gjatë i filmit "Diku pranë shtëpisë sime"

Menjëherë pas shfaqjes së filmit u organizua edhe një koncert, ku morën pjesë shumica e rok-grupeve kosovare. Unë, shfrytëzova rastin të takoja edhe familjen e Uranit, të cilët i falënderoj për mikpritjen që më bënë.

Po ashtu falënderoj Poqin, anëtarët e Bendit "Babilon", Migjen Kelmendin, grupet pjesëmarrëse në atë koncert si dhe të gjithë të pranishmit e asaj mbrëmjeje të mrekullueshme. Edhe diçka, të mos mbetem borxh: edhe pse ishim nën okupim, yjet tona i nderonim me dinjitet. Në këtë grup bën pjesë edhe Urani dhe shokët e tij.

Ju premtoj që në të ardhmen, do të shihni edhe versionin e gjatë të filmit ***"Diku pranë shtëpisë sime"****.*

Unë ju uroj shumë sukses në punën tuaj për të rikujtuar Uran Bajramin, djaloshin e talentuar, të cilin e njoha vetëm përmes teksteve të tij superiore dhe muzikës së shkëlqyeshme me grupin e tij, Babilon.

Me nderime,
Agim Faik Gërbeshi
Diku pranë shtëpisë sime - USA

KRIJIME (POEZI TË BOTUARA) NGA URAN BAJRAMI

BABILON

E tërhiqnin aventurat
lojërat pa fund
udhëtimet e largëta
dhe fitimet pa mund.

Adhuronte Morisonin
me gjithë ato marri
ëndërr e saj ish Babiloni
dhe perënditë e tij.

Babilon
ëndrrat jetojnë përgjithmonë
Babilon
shpirti i saj shtegton.
E magjepsur bota e ëndrrave
jeta pa brenga shumë
i donte ditët plot diell
dhe netët pa gjumë.

Ajo kërkonte fëmijërinë
e humbur pa faj
tërë bota qeshte me të
dhe me ëndrrat e saj.

(Botuar në Zëri i Rinisë, tetor 1989)

Ky tekst (kjo poezi) është kompozuar në këngë. Muzikën e këngës e bëri B. B. Poçi, i cili edhe e këndoi, meqë ishte vokalist i AVI "Babilon", është incizuar në Radio Prishtinë, Producent Tomor Berisha.

Incizues Ilir Hoxha.

Kënga është bërë shumë shpejt hit dhe si e tillë këndohet edhe sot e kësaj dite nga grupe të ndryshme të Rokut Kosovar.

ËNDRRA

Tërë kohën eci
me zemër të thyer
në fund po e shoh
ku qeshë jam kthyer

Shikoj përpara
asgjë s'dalloj
vazhdoj të eci
rrugëdalje kërkoj

Shikoj përpjetë
as qiell as re
labirint i shkretë
dalje a ke

N'dorë e kam ardhmërinë
ti nuk ke shpëtim
ti je vetëm ëndërr.

(Botuar në Zëri i Rinisë, tetor 1989)

EDHE NJË NATË SI KJO

Edhe sonte dua të jem me ty
le të na përkëdhelin stuhitë
e natës
edhe sonte le të jemi bashkë
ne të dy
le t'u dorëzohemi ndjenjave
dhe imagjinatës.

Kalo vetëm edhe këtë natë
me mua
t'i shtrijmë duart kah qielli i errët
do të gënjeja sikur të të them
se të dua
a ndoshta është vonë, ndoshta
tepër herët.

Harroji të gjitha brengat e shpirtit
dhe botën pranë teje që të rrethon
nata do të kalojë si disa çaste
shumë shpejt mëngjesi i ditës së re
agon.

Dhe kur e nesërmja do të vijë
unë do të jem shumë larg nga ti
kërko hijen nëpër këndet
e zbrazëta
ku qëndronim netëve të gjata
pa yje.

Unë do të jem atje
ku më thërrasin shpirtrat
unë do të jem atje
atje ku vallëzojnë engjëjt
më thirr nëse të duhet
edhe një natë si kjo
edhe një natë si kjo.

(Botuar në Zëri i Rinisë, tetor 1989)

Ky tekst (kjo poezi) është kompozuar në këngë. Muzikën e këngës e bëri Besim Hajdini, ndërsa B,B.Poqi e këndoi. Është incizuar në Radio Prishtinë, Producent Tomor Berisha.

Incizues Ilir Hoxha.

Kënga është bërë shumë shpejt hit dhe si e tillë këndohet edhe sot e kësaj dite nga grupe të ndryshme të Rokut Kosovar.

VETËM SHKO

Perdja ra – loja mori fund
u ndezën drita: komedia mbaroi
unë s'kam faj, pse s'të deshi
askush
marritë e tua fare nuk i kuptoj.

Zgjidhje s'kam, shko përgjithmonë
s'jam më hija jote e besuar
nata po shkon, është tepër vonë
harroji të gjitha,
si unë që kam harruar.

Vetëm shko lëri premtimet, harroji mëkatet

Më harro
nata po na ndan
ashtu siç na i bashkoi fatet

Vetëm shko
lojës së re filloja sot

Më harro
në jetën time ishe
vetëm një episod.

(Botuar në Zëri i Rinisë, tetor 1989)

TI JE VETËM NJË ILUZION

Sonte hesht qyteti
Shiu do të fillojë
Kërkoj shikimin tënd
Në errësirë
çiftet rrugës kalojnë
Më marrin për të marrë

Kjo natë më kujton gëzimet
Dhe dashurinë e parë
Çastet më duken shekuj
Nata më është e gjatë pa ty
Fëmijërinë ma morën ëndrrat
E ëndrrat m'i more ti

Larg fryjnë erërat
Bartin pluhurin e gjurmëve të tua
Ti shkove por kujtimi yt jeton thellë
Diku në mua.

Ti je vetëm një iluzion dhe asgjë më shumë
ti je një ëndërr që më mbulon a të kujtohem unë.

P.S. Titulli origjinal i kësaj poezie që është bërë këngë është: "Baladë për...". Vjersha në një variant tjetër u gjet në një fletore të ruajtur nga Besim Hajdini.
Muzika: Besim Hajdini, këndoi B.B. Poqi.

Varianti i këngës "Ti je vetëm një iluzion" që këndohet, është ky:

Sonte hesht qyteti
shiu do të fillojë
kërkoj shikimin tënd n'errësirë
çiftet rrugës kalojnë
më marrin për të marrë
kjo natë më kujton gëzimin dhe dashurinë

çastet më duken shekuj
nata më është e gjatë pa ty
fëmijërinë ma morën ëndrrat
e ëndrrat m'i more ti
larg fryjnë erërat bartin pluhurin
dhe gjurmët e tua
ti shkove, por kujtimi yt
jeton thellë diku në mua

Sonte hesht qyteti
shiu do të fillojë
kërkoj shikimin tënd n'errësirë
çiftet rrugës kalojnë
më marrin për të marrë
kjo natë më kujton gëzimin dhe dashurinë

çastet më duken shekuj
nata më është e gjatë pa ty
fëmijërinë ma morën ëndrrat
e ëndrrat m'i more ti

larg fryjnë erërat bartin pluhurin
dhe gjurmët e tua
ti shkove por kujtimi yt
jeton thellë diku në mua

Ti je vetëm një iluzion
dhe asgjë me shumëëë
ti je një ëndërr që më mundoi
a të kujtohem unëëë

Ti je vetëm një iluzion
dhe asgjë me shumëëë
ti je një ëndërr që më mundoi
a te kujtohem unëëë
eeeeeee

Ti je vetëm një iluzion
dhe asgjë me shumëëë
ti je një ëndërr që më mundoi
a të kujtohem unëëë

(nxjerr nga interneti)

DIKU PRANË SHTËPISË SIME

Sikur të ktheheshim e të shikonim
gjurmët që i lamë dikur
dhe ditët që s'do të kthehen më kurrë
i kujtoj çastet që kaluam
ishim të rinj, të marrë e të dashuruar
ende pyes veten-athua ku gabuam.

Vitet kaluan si disa çaste
dielli shumë shpejt perëndoi
diku pranë shtëpisë sime
çdo gjë mbaroi

diku pranë shtëpisë sime
ditët kalojnë, ne nuk jemi aty
diku pranë shtëpisë sime
agimet zbardhin me kujtimin për ty
me kujtimin për ty.

(Botuar në "Bota e Re", nëntor 1995)

Ky tekst (kjo poezi) është kompozuar në këngë. Muzikën e këngës e bëri Besim Hajdini, e këndoi B.B. Poqi. Është incizuar në Radio Prishtinë, Producent Tomor Berisha.

Incizues Ilir Hoxha.

Kënga është bërë shumë shpejt hit dhe si e tillë këndohet edhe sot e kësaj dite nga grupe të ndryshme të Rokut Kosovar.

Vështrim kritik për poezitë e botuara të Uran Bajramit

POEZI E VETËPËRKUSHTIMIT DHE E PARANDJENJËS

Aventurën e tij prej krijuesi, Uran Bajrami më seriozisht e fillon me poezinë **BABILON,** vargjet e të cilës poezi më pas u bënë shkas për t'u themeluar Bendi me emërtimin e njëjtë dhe kjo u bë kënga e parë e kompozuar dhe e kënduar nga ky Bend.

Të gjitha poezitë e Uran Bajramit që janë gjetur e botuar, e që nuk janë shumë, (tani së fundi u gjetën edhe të tjerat) janë poezi përkushtuese që me vargjet e tyre, krijuesi mbase është munduar të paraqes një realitet rinor plot elan e dashuri për jetën, por në të njëjtën kohë nuk lë pa përmendur as hendeqet që i dalin para e nuk e lënë të ec e të shoh atë që pretendon ta kap.

Poezia e vetme që nuk ka të bëjë me jetën dhe brengat e krijuesit, por që paraqet një epokë shumë të lashtë, e që duket autorin e ka frymëzuar leximi i librit mbi Civilizimin e lashtë në Babiloni, është mu poezia e titulluar BABILON, e që është një nismë drejt një shtegu jo edhe të gjatë krijues.

Lexuesi që ka pasur rastin t'i lexojë këto poezi të pakta apo edhe t'i ketë dëgjuar të kompozuara në këngë, por edhe ju që tashmë e keni në dorë këtë monografi, do të bindeni që Urani, në secilën poezi ka shënuar diçka që do të kujtohet me vite.

Do të kujtohet, sidomos me ato parandjenjat për fundin e jetës...

Me këtë konstatim, do të bindeni, menjëherë pasi të keni lexuar poezinë "**ËNDRRA**".

Uran Bajrami ëndërron për diçka që nuk mund ta arrijë. Sheh veten duke ecur e shikuar herë para e herë përpjetë, e askund s'sheh dalje... Kjo ndjenjë e tij

paraqitet te vargjet: ***Tërë kohën eci me zemër të thyer-në fund po e shoh ku qeshë jam kthyer.***

Sikur humb shpresën e atij udhëtimi në kohë dhe hapësirë. Për të vazhduar më tej me dilemën tjetër: ku do të mund ta përplaste jeta, sepse nga ai labirint që është katandisur, rrugëdaljen s'e gjen dot.

Megjithatë, torruan nuk e humb, ngushëllon veten me vargjet: ***N'dorë e kam ardhmërinë/ ti nuk ke shpëtim/ ti je vetëm ëndërr.***

Në vjershën e dytë **EDHE NJË NATË SI KJO**, autori i vargjeve shpreh dëshirën të përsëritej edhe një natë, në të cilën ai me të dashurën, do të përkëdhelen nga ***stuhitë e natës***. Ja si shprehet në vargjet e para të kësaj poezie: ***Edhe sonte dua të jem me ty/ le të na përkëdhelin stuhitë/ e natës.*** Për të vazhduar me dëshirën e dytë: ***edhe sonte le të jemi bashkë/ ne të dy /le t'u dorëzohemi ndjenjave/dhe imagjinatës.***

A thua çfarë deshi të thotë poeti i ri me këtë dëshirë. Cila ishte ose cilat do të mund të ishin ato ndjenja të imagjinatës që do t'u dorëzohen ata. Mos ndoshta mu ajo që ai thoshte apo shprehte si dëshirë, ishte vetë ajo imagjinata që e kishte mbuluar me kthetra në moshën e djalërisë, kur ai nuk mund t'i kishte as tetëmbëdhjetë pranvera. Sepse këto poezi të cilat u bënë këngë, ishin shkruar nga thellësia e shpirtit dhe mu për këtë edhe u bënë këngë që, do t'i këndojë ai me shokët e grupit "**Babilon**".

Edhe më shumë. Jo vetëm që u bënë këngë sa për t'u thënë, por, si të tilla, ruajtën muzikalitetin,

ritmikën dhe aktualitetin e poezisë që lexohet, këndohet dhe kuptohet lehtë.

Është e çuditshme që, gati në çdo poezi, autori, sikur paralajmëron ikjen e tij. Shkuarjen, udhëtimin...

Do të bindemi që e përcillte diçka si hije që ia rrëfente udhën. Shikoni këto vargje të po kësaj poezie dhe vlerësoni vetë, çfarë e shtyn atë që të konstatojë për diçka që do të vijë tek të nesërmen: ***Dhe kur e nesërmja do të vijë/ unë do të jem shumë larg nga ti.***

Çfarë mesazhi dhe parandjenje i jep të dashurës që e simpatizon. E simpatizon, por për një çast sikur harron dashurinë, përnjëherë i shpreh një të vërtetë: ***do të gënjeja sikur të të them se të dua/ a ndoshta është vonë/ ndoshta tepër herët.***

Sikur me këtë do t'ia bëjë me dije që ajo nuk është person i duhur që, ai e dashuron, mbase, për shkak të parandjenjës që shumë shpejt do të ik e ajo do të mbetet vetëm me kujtimin për të. Andaj, edhe e paralajmëron që të mos lidhet me të, sepse, do të mbetej e zhgënjyer. E paralajmëron dhe e njofton që shumë shpejt do të ik nga kjo botë dhe do t'i bashkëngjitet yjeve dhe engjëjve. Kjo hapur kuptohet në vargjet e fundit të kësaj poezie: ***Unë do të jem atje/ ku më thërrasin shpirtrat/ unë do të jem atje/ atje ku vallëzojnë engjëjt/ më thirr nëse të duhem...***

Menjëherë pas kësaj, vjen episodi tjetër i jetës edhe ashtu të shkurtër të Uranit. Episod ky i ndarjes nga e dashura ose humbja e simpatisë, ngase siç shprehet nëpërmjet vargjeve të poezisë së titulluar:

Vetëm shko, duket që në mënyrë të qëllimshme do të ndahet nga e dashura e vet. Nga ajo që mbase e simpatizon aq shumë, për t'i bërë ndarjen më të lehtë dhe për t'i mundësuar ta harrojë sa më shpejt. Mbase flet edhe fjalë të panevojshme dhe të pa menduara mirë. Por, qëllim i tij, duket që nga vetë brendia e egos së shpirtit të tij, ishte që, sa më pak njerëz të vuajnë pas ikjes së tij. Kjo nuk do të thotë që e ka ditur dhe e ka lexuar aksidentin tragjik, por, ndërdija e tij flet për një gjë të tillë. Ajo që do të duhej të përmendej është edhe momenti kur në vargjet e fundit porositë ish të dashurën: ***Vetëm shko/ lojës së re filloja sot/ Më harro/ në jetën time ishe/ vetëm një episod.***

Nuk do mend që afiniteti i Uranit për krijime letrare nuk përfundon me këto. Vazhdon ai me poezinë e radhës, në të cilën paraqet një realitet të ri, tani pa të dashurën që e ka braktisur.

Nëpërmjet vargjeve të poezisë: **Ti je vetëm një iluzion,** shfleton ditët dhe mbrëmjet, kur shëtit rrugëve të qytetit i ngarkuar me barrën në shpirt-humbjen e dashurisë.

Që në fillim të poezisë (tekst kënge) ndjenjën e vetmisë e paraqet kështu: ***Sonte hesht qyteti/ Shiu do të fillojë/ Kërkoj shikimin tënd/ Në errësirë/ çiftet rrugës kalojnë/ Më marrin për të marrë***. Ashtu i vetmuar ec me kujtimet e dashurisë së parë, e nata assesi të mbarojë, për të përfunduar mendimin me vargjet: ***Nata më është e gjatë pa ty/ Fëmijërinë ma morën ëndrrat/ E ëndrrat m'i more ti***.

Megjithatë, edhe pse i brengosur dhe i mërzitur për atë dashuri të dështuar, vetes dhe të dashurës nuk harron t'i jep kurajë në vargjet vijuese: ***Ti shkove por kujtimi yt jeton thellë/ Diku në mua.***

Dhe kur duket që bindet me realitetin tashmë të krijuar, përfundon poezinë duke e ngushëlluar veten me vargjet: ***ti je një ëndërr që më mbulon/ a të kujtohem unë***.

Kulmi i krijimtarisë së tij të shkurtër, arrin me poezinë vijuese, mbase të fundit: **Diku pranë shtëpisë sime,** ku, hapur shpreh hijen që e përcjell dhe e largon nga shtëpia. Në ndërdijen e tij ndjen diçka që gjithçka do të mbarojë diku, pranë shtëpisë së tij.

Kështu shprehet Urani: ***i kujtoj çastet që kaluam/ ishim të rinj, të marrë e të dashuruar/ ende pyes veten-athua ku gabuam***. Nuk ndalet me kaq. Sepse, ende nuk e ka nxjerr në pah hijen që e ndjek prapa.

Këtë e shpreh në vargjet vijuese: ***dielli shumë shpejt perëndoi/ diku pranë shtëpisë sime/ çdo gjë mbaroi***. Për të ardhur në fund të parandjenjës së tij: ***diku pranë shtëpisë sime/ ditët kalojnë, ne nuk jemi aty***... dhe me të drejtë, mund të konstatohet që poezia e Uranit ka një motiv: atë të dashurisë, por që nuk do të ketë kohë ta shijojë. Sepse, vdekja ishte e pamëshirshme. E mori, për të na lënë vetëm kujtimin për të.

Ferid Selimi

KRIJIME (POEZI) TË PABOTUARA

Në fletoren që gjetëm e që Besimi e kishte ruajtur, Urani kishte shkruar edhe këto vjersha...

(Një mori vjershash që dyshohej të kishin humbur diku, u gjetën rastësisht në një fletore që Besim Hajdini e kishte ruajtur me xhelozi edhe njëzet vjet pas. Këto krijime (vjersha) deri më tani, për publikun ishin të pa njohura. Ne, i botuam ashtu si ishin. Qëllimisht i lamë, le të flasin vetë ato dhe lexuesi le të vlerësojë talentin e Uranit).

BALADË PËR...

Varianti origjinal i këngës:
"Ti ishe vetëm një iluzion
(vërejtje e autorëve)

Sonte hesht qyteti
shiu do të fillojë
kërkoj shikimin tënd n'errësirë
sytë e tu nga larg më ftojnë

çiftet rrugës kalojnë
na shikojnë si të marrë
kjo natë më kujton gëzimet
dhe dashurinë e parë

vështirë kalon koha
netët janë të gjata pa ty
fëmijërinë ma morën ëndrrat
e ëndrrat m'i more ti

larg fryjnë erërat
bartin pluhurin dhe gjurmët e tua
ti shkove, kujtimet jetojnë
thellë diku në mua

sonte bredh i vetëm
endacakët më bëjnë shoqëri
dëgjoj fjalët që humbin në natë
çdo gjë më thërret kah ti
Treni i mesnatës sjell

fytyra të reja plot
të kërkoj diku në turmën e gëzuar
por e di se mundohem kot

Ti ishe vetëm një ëndërr
dhe asgjë më shumë
sa agime do të zbardhin
duke të pritur unë
të desha vetëm një natë
si një çast që kalon
sonte gotat i zbraz
kujtimi yt më mundon

Në variantin e parë të vjershës qëndrojnë edhe këta vargje, që Urani më vonë i heq.

... ndoshta takohemi përsëri
unë, mesnata dhe ti
ti, mesnata dhe unë

... ti sonte tjetrin përkëdhel
jeton me ëndrrat e tij
ndoshta do të mësohem
të jetoj pa ty
unë, mesnata dhe ti

Sipas informacionit që na dhanë Besim Hajdini, B. B. Poqi, Mentor Haziri (anëtarë të Rok-grupit "Babilon"), si dhe shokët e fëmijërisë: Dritoni, Ardiani e Arbëri, kjo vjershë, më vonë, pëson ndryshime. Urani e kreh vjershën dhe i ndërron disa nga fjalët. Ndërsa titullin e origjinalit në dorëshkrim e emërton: "Baladë për..."

IN MEMORIAM

Është dita kur thyhen ëndrrat
është dita kur falen mëkatet
është dita kur ngjallen shpirtrat
është dita kur vdesin legjendat

ndoshta e gjen veten diku
në fëmijërinë e humbur pa faj
ndoshta jashtë në fusha
lulet janë shpresat e humbura

PA TITULL

Ndoshta një ditë do të kujtohem
por, unë, atëherë do të jem larg nga ti
kërko hijen time nëpër këndet plot pluhur
do të shohësh dy engjëj, një shpirt e mijëra sy...

RIKTHIMI

...Unë do të kthehem përsëri atje
atje ku takova atë...

MOS TROKIT NË DERËN TIME

Kot troket në derën time
s'do të më gjesh aty
shpejt harrove vuajtjet e zemrës sime
unë dua të shkoj sa më larg nga ti

Atëherë, kur të gjithë do t'harrojnë
kur të të mbushet zemra plot hidhërime
atëherë kur të gjithë dikah larg do të shkojnë
atëherë do të trokitsh përsëri në derën time

BALADA PËR TË MARRIN

Vetëm edhe një natë çdo gjë do të marrë fund
Edhe një natë dhe yjet do të shuhen
diku larg në horizontet e pafund
Kudo që të jesh, kah do që të shkosh
kujto natën që kaluam bashkë të dy

GJITHMONË I RI

Pa para na xhep
por i lumtur në jetë

Më vjen të qaj, ku e di
se s'do të jem gjithmonë i ri

DUHET TË DISH...

Ti duhet të dish se është vonë
vonë për të gjitha
ti duhet të dish se kthim –
kthim më nuk ka.

GJENERATA IME

Gjenerata ime jeton me shpresën
se një ditë do të rritet

Mjegulla më mbron nga shikimet e tyre
e gjitha ç'më duhet je ti...

EDHE TASH MË NDODH

Sonte flas me shirat e natës
Më vjen të qaj kur e di
që s'je vetëm...
...kur e di
që dikush... është me ty

PA TITULL...

Atëherë kur tmerri
tërë trupin ta kaplon
fytyra zbehet
humbin shpresat për jetë

kur të kap frika
e të mundon vetmia
kërkon ndihmë...
...hija jote të ndjek

kur era çdo gjë
rreth teje shkatërron
hapa të rëndë
dëgjohen në afërsi

veshët nga zhurma
të fishkëllejnë

shumë zëra të çuditshëm
vijnë ka' ti

QIELLI MBI NE

Sonte këtu po qan qielli mbi ne
gjithkah kthjellët, askund re
e fqinji im thotë se po i sheh
në kokë të fëmijëve, më bën be

Thotë: shiko kojshi a s'po i sheh
tërë këto re të zeza mbi ne,
a po dëgjon, si bubullon
do të ketë breshër, a më dëgjon?

Çova kokën, por s'shihja gjë
qielli i kaltër sa s'bëhet më,
thashë vetë me vete: ç'paska kojshia
mos paska ëndërruar ca ëndrra të këqia.

Eh, i thashë, more kojshi
si po e bën qiellin e kaltër, të zi
si mund qielli i kaltër të bëhet i zi
ec mor kojshi, të shkojmë në shtëpi
se punët e Zotit, askush s'i di

Ec o kojshi e çojmë nga një gotë raki
nesër ditë e re, do të bëhet më mirë.
Po fqinji s'dëgjonte
atje ende qëndronte.
tha: dua t'më lag
breshëri sonte...

E DI...

Edhe një natë pa gjumë
në dhomë i vetëm rri,
dhe nuk e di
pse m'u kujtove ti.

I kujtoj ditët që kaluam
ishim të rinj. Të marrë dhe të dashuruar
ende pyes veten a thua ku gabuam
apo ndoshta të dy – tepër kërkuam.

E di se edhe ty të mundon
kujtimi për mua.

E di se ende jeton
thellë diku në ëndrrat e tua.



Dorëshkrim i nxjerrë nga posteri në dhomën e Uranit

QETËSI MBI QYTET

Ishte dita e fundit e marsit dhe, pranvera veç kish filluar të tregonte shenjat e para të ardhjes së saj, kur një djalosh ngadalë po zbriste rrugës kryesore të "qytetit të madh", me një hap të çrregullt dhe kokëulur sikur qielli plot freski pranverore t'i kishte rënë mbi kokë.

Ecte pa kujdes, dhe dukej si çdo moment do të rrëzohej. E kishin lodhur tërë brengat e asaj dite dhe mezi priste t'i shtrinte kockat në krevatin e tij të vjetër e t'i dorëzohej gjumit sa më parë. Rrugës kishte fare pak kalimtarë dhe një grua e moshuar e shikoi me habi të ecurit e tij të dehur, kur ky kaloi pranë saj. Kjo gjë e habiti edhe atë vetë dhe sikur shpejtoi pak hapin. Me nguti kaloi pranë semaforave të ndezur dhe arriti para kinemasë, prej nga mori rrugën për në shtëpi.

Dielli veç kish perënduar kur ai arriti para dyerve të shtëpisë së tij. Nga larg dëgjoheshin vetëm të lehurat e qejve dhe dukej sikur çdo gjë po pregatitej për pushim. Qetësia kishte kapluar tërë qytetin, pas asaj dite plot zhurmë e tollovi.

- Tak, tak, tak - u dëgjua zhurma e shurdhër e dorëzës së hekurit që shërbente si një lloj zileje.

- Ah, Petriti - klithi Shpresa e vogël kur doli t'ia hapte derën. Ai e shikoi me dashuri dhe e përqafoi. Sikur ishte përmalluar për motrën e tij të vogël, gjatë këtyre dy ditëve të fundit sa kishte qenë në fshat. Shpresa e vogël s'i hiqej të vëllait nga qafa andaj ky,

deshi s'deshi u desh ta mbante atë ashtu gjer te dera e dhomës së ditës, ku zakonisht rrinin tërë familja. Në dhomë ishte vetëm gjyshja e tij. Gjyshja menjëherë e vërshen me pyetjet e saj të pafund, se a e kishte kryer punën për të cilën e kishte dërguar i ati, se si ishin axhallarët etj, etj. Ai i përgjegjej pa kurrfarë vullneti. Ishte i rraskapitur e mbi të gjitha i uritur si ujk. Darkoi me oreks të madh dhe filloi të çfletonte një gazetë të vjetër që kushedi prej sa ditësh rrinte mbi tavolinën e bukës.

Gjumi ia rëndonte qepallat por nuk i shkohej të flinte. Ngadalë pa vullnet hipi shkallët dhe u ngjit në dhomën e tij të vogël. U shtri mbi krevat si pa ndjenja. Papritmas, nga larg dëgjoi disa zëra të çuditshëm, që në fillim ishin ishin të paartikulluar, por sa vinin e kthjelloheshin. Ishte zëri i një njeriu i çili lajmëronte me altoparlant se nesër një cirk i madh evropian do të çfaqte program. E mbuloi kokën me jorgan, sepse nuk mund ta duronte atë zë kumbues. E kishin kapluar ethet dhe sadoqë ishte tepër i lodhur nuk e zuri gjumi deri vonë. I vinin gjithfarë mendimesh atë natë. Nuk dinte as vetë përse, por i kujtohej çdo imtësi e qëndrimit të tij dyditësh në fshat. Bukuria e fshatit dhe njerëzit e hareshëm e gjithmonë buzagaz e kishin fascinuar këtë djalosh që sapo kishte shkelur te tetëmbëdhjetat. Mjaft shpesh shkonte në fshat, por asnjëherë s'i kishte ndodhur kjo gjë. Thjesht, ishte magjepsur me ato që kishte parë gjatë dy ditëve të kaluara. Këtu, në qytet i dukej sikur çdo moment do t'i zihej fryma. Këtë e kuptoi

qysh kur kaloi shtëpitë e para të qytetit, gjatë ardhjes së tij nga fshati. Me qëllim kishte ardhur këmbë, jo pse s'kishte para për autobus, por vetëm e vetëm që t'i shmangej tollovisë që krijohej aty të shtunave, sepse ishte ditë pazari. Kishte dashur t'i shfrytëzonte ato dy orë ecje, që të kënaqej me cicërimën e zogjve dhe dallëndysheve.

Urani, Donika, Lavoni dhe Lumi

- Sa keq, -mendoi me vete, këtu në qytet nuk ka as zogj as dallëndyshe që ta kënaqin shpirtin me këngën e tyre të bukur. Dhe vërtet nuk kishte, ose kishte fare pak. Edhe ato që ishin, ishin disi më të zymta sesa shoqet e tyre prej fshati. Zhurma e madhe dhe ajri i papastër që krijohej nga fabrikat dhe automjetet në qytet, i pengonte edhe ato sigurisht.

Përnjëherë, u çua nga shtrati dhe ndezi dritën për të shikuar orën. Ishte ora dy pas mesnate. Përkoi sytë mos ndoshta ishte në ëndërr, por jo. Nuk u besonte syve. Ora ishte bërë dy, e ky rrinte zgjuar si ndonjë lakuriq nate. Fiku dritën dhe u shtri në krahun tjetër.

ORA E MADHE E QYTETIT...

Agimi posa kishte filluar t'i lëshojë krahët e tij të argjendtë në qytet, kur Uka po kthehej në shtëpi nga një shëti e gjatë nate.

Ishte sorollatur tërë natën rrugëve të pafund pa e ditur as vetë shkakun e asaj bredhjeje të çuditshme. E mundonin shumë gjëra prej asaj dite kur ishte takuar me atë. As e kishte dashur kurrë më parë atë vashë, as i kishte vajtur pas siç bënin shokët e tij të dashuruar, por ja që ajo i kishte ardhur vetë. Iu kishte afruar butë me një "tung" të shkurtër dhe me një buzëqeshje të lehtë, që e kishin bërë për vete Ukën prej ditës së parë…

Ajo quhej Vjosa.

Shkonte në një shkollë me të.

Uka e kishte njohur edhe më parë. Shiheshin zakonisht gjatë pushimit ose pas mësimit, por asnjëherë s'i kishte rënë në sy as ndonjë shenjë apo gjest më i vogël që do të shprehte simpatinë e saj ndaj tij. Nuk e kishte vënë re një gjë të tillë jo pse ajo nuk i kishte dhënë shkas, por për shkak se e dinte se ajo zbavitej me një shok shkolle të tyrin afër një vit. Ishte i dhënë pas mësimit dhe aktiviteteve sportive në shkollë andaj nuk ia vente veshin fort atyre gjërave. Por, dita më ditë ajo filloi t'i afrohej haptazi pa çarë kokën për dashurinë e saj i cili edhe ashtu nuk e çmonte fort dhe përhapte për të lloj-lloj gënjeshtrash, e të cilat me ditë të tëra ishin temë bisede e vajzave të shkollës.

… Ora e madhe e qyteti ra njëmbëdhjetë herë. Uka nxori me kujdes orën e tij të xhepit dhe e shikoi sikur donte të bindej se nuk i kishte mbetur më shumë se një orë dhe…

- Ah, pësherëtiu thellë dhe hodhi shikimin kah qyteti...

'88, Uran Bajrami

VARGU QË U BË PËRJETËSI...

Duke i lexuar vëmendshëm poezitë e gjetura në fletoret e shokëve, më konkretisht në fletoren e "kujtimeve" të tij që me aq xhelozi e kishte ruajtur për dy dekada, Besim Hajdini, e që në rastin konkret kur po bëjmë një punë modeste për ta ndriçuar sadopak botën imagjinative të Uran Bajramit, jo vetëm si roker i Babilonit, që deshën të arrijnë në zenitin e famës së tyre nëpër kohë dhe hapësirë, por edhe në rrafshin tjetër – në atë të poezisë, përkatësisht të vargnimit.

Po t'i hedhësh një sy e ta fusësh veten në botën imagjinative të trembëdhjetë poezive të pabotuara të Uran Bajramit dhe gjashtë poezive të botuara, që, pa dyshim përbëjnë një cikël vjershash nga më të ndryshmet, por që e kanë një ind dhe emrues të përbashkët, poemën për jetën, gjithsesi, lexuesi do të përfitojë një pasqyrë apo bindje se kemi të bëjmë me një talent të ri, të cilit i kishte zbritur muza poetike në vargun e tij që në vitet e adoloshencës, për t'ia shtuar edhe më gradacionin, jo vetëm tingullit e notës së këngës në pentagram, por edhe fjalës e cila rrjedh aq shlirshëm, aq natyrshëm, sa që ke bindjen që je duke lexuar poezitë e një autori, krijuesi me përvojë solide.

Mosha, kur i shkroi autori këto vjersha ishte ajo e djalërisë së hershme. Motivet për vjershat i gjeti në ambientin ku jetoi dhe veproi. Hapërimet e tij ishin aq të guximshme, sa që për kohën dhe ëndrrën e tyre mund të thuhet lirisht që edhe murin mund ta

lëviznin me forcë dhe me fuqinë e fjalës, me gjakun që u vlonte në damarë, ata bënin gjithëfarë revolucionesh brenda vetes, brenda kujtimit, shikimit, bredhëritjeve, ëndërrave dhe ëndërrallave që, dorën në zemër, si fazë jete, të gjithë e kemi kaluar dhe ajo ka lënë gjurmët më të thella në pluhurin e kohës, do të thotë Urani në një varg të vetin. Apo:

Sonte hesht qyteti/ Shiu do të fillojë/ Kërkoj shikimin tënd n'errësirë/ Sytë tu nga larg më ftojnë...

Këtë e thotë në poezinë "Baladë për..." që është një poezi e cila ka shumë figurshmëri, ka metafora dhe simbole, ka në brendinë e vet edhe zjarrin, edhe mallin, edhe kujtimin, po edhe përpëlitjet për të hapëruar si çdo adoloshent nëpër udhëkryqet e kujtimeve, duke e spërkatur me fjalë e imagjinatë, por edhe me fantazi, fjalën e parë për një dashuriçkë, e cila duhet të jetë vetëm si një embrion për një dashuri të pastër, për një idilë shpirti që, do të pasojë në rrugëtimin jetësor.

Andaj, në poezinë e Uran Bajramit janë këto gjetje që flejnë dhe sedimentohen e i bëjnë ballë tërë viteve të ikura që do të përjetësohen edhe për brezat që vijnë. Nëse ato lexohen dhe komentohen nga brezat e rinj, që po ashtu kanë botëkuptimet dhe qasjet e tyre për jetën, e mbi jetën, në formën dhe mënyrën e vet.

Pra, nuk është e tepërt të theksohet se e gjithë poezia e Uranit është një ligjërim që të bën për vete, të bën ta përjetosh, sepse ajo e ka ngjyrimin e kohës, e ka ngjyrimin e moshës rinore, e këtë e vërejmë edhe kur këndon:

...ndoshta takohemi përsëri/ Unë, mesnata dhe ti/ Ti, mesnata dhe unë

Është kjo urëlidhjsja apo pikëtakimi i njerëzve, të cilët me gjithë bagazhin e jetës, udhëtojnë në paskajësi deri në stacionin e fundit. Urani nuk i përket as ndalesës në të, sepse poetët dhe krijuesit kurrë nuk kanë kohë, ata e kanë gjithmonë kohën e tashme. Sepse, me vargun e tyre bëjnë që të lexohen e përsëriten në udhëtimet e gjata, nëpër vendndodhjet dhe në ndarjet që lënë gjithmonë shpresën, kujtimin dhe shikimin për ta rikthyer në mbamendje gjithë botën e vogël të njeriut në këtë hapësirë:

Intima është temë e çdo krijuesi, Sekreti është pjesë përbërëse e imagjinatës dhe trurit. Atë duhet kultivuar përherë. Këtë e bën edhe Urani në vjershat e veta. Dhe, mu kjo, ia shton gradacionin vargut dhe strofës. I jep kuptimësi e gjerësi analizimi e qasje për ta zbërthyer enigmën, brengën dhe mallin për njeriun dhe jetën. Vetmia, shpesh kur i vidhet natës futë, pagjumësia arrin deri te portat që hapen vetëm me magjinë e fjalës:

Kot troket në derën time/ S'do të më gjesh aty/

Po i analizuam këto vargje, pa dyshim që do të mësojmë edhe për simpatirat që thuhen shpesh me fjalë, për ato ëndrrat dhe odet që i bëhen dashurisë. Për serenatat e pakryera, por që të gjitha mbeten vetëm pjellori imagjinative, pa u sendërtuar në bazamentin e kohës, sepse, poeti i ri, kohën e ka shtrirë përpara dhe rrugëtimin e vazhdon nëpër të duke u ballafaquar me gjitha të mirat e të këqiat, me bardhezinë metaforë, me ngritjet dhe zbritjet që i ka jeta. Ai është një regjistrator i denjë i çasteve dhe i momenteve jetësore që i japin shkas të shkruaj, të ligjërojë, dhe, së fundi gjitha këto vargje si një tufëz t'i këndojë me Bendin BABILON. Për të arritur deri këtu, duhet pasur vizion, sfidë, iluzion, barrë të madhe për t'u ballafaquar me realitetin...

E, këtë e ka pasur, pa dyshim gjenerata e Uranit. Andaj edhe vargu i tij është i ngjeshur, i thënë me një kuptimësi e denjësi, me një thellësi mendimi:

Gjenerata ime jeton me shpresën/ Se një ditë do të rritet...

Për të përmbyllur këtë shkrim – ese të shkurtër, po theksojmë se gjenerata e pasviteve të tetëdhjeta, pati fatin e keq. Ndodhën aq shumë ngjarje dhe turbullira, saqë vështirë ishte të herrej bima e keqe që kishte lëshuar rrënjë në të gjitha segmenetet e jetës:

Sonte flas me shirat e natës/ Më vjen të qaj kur e di/ që s'je vetëm...

Na mban shpresa se në të ardhmen do të gjenden edhe dorëshkrime të tjera që gjenden ndër miq e shokë dhe në një përvjetor përkujtimi për këtë talent të ri, që i dha jetë dhe frymë vargut, do të botohen edhe poezitë e tjera që, pa dyshim do ta ngritin edhe më lart vlerën idoartistike të krijuesit Uran Bajrami, i cili, edhe kështu, me këto vargje dhe poezi, la një testament për shokët e gjeneratës, por edhe për të tjerët që janë në maratonën jetësore. Sepse, njerka harresë nuk mundi të bëj vend falë shokut të fëmijërisë Besim Hajdinit, i cili shpalosi pluhurin e kohës, duke i zbuluar këto krijime...

Jonuz Fetahaj

SHKRIME NËPËR GAZETA PËR URAN BAJRAMIN DHE VEPRIMTARINË E TIJ MUZIKORE

Ja si e paraqet lajmin për xhirimin e filmit të metrazhit të shkurtër nga regjisori shqiptar që ka studiuar dhe jeton në Amerikë, Agim F. Gërbeshi, gazeta e përditshme "Koha Ditore" (...nëntor 1996)

New York-Prishtinë

"DIKU PRANË SHTËPISË SIME"

Në vitet e tetëdhjeta, rok-skena kosovare ishte përplot ndodhi. Grupet e reja, incizimet e shumta dhe koncertet e shpeshta, ishin shenjë e asaj kohe. Por, nuk janë të gjitha kujtimet e mira. Më 1989, një aksident trafiku ndërpreu rrugën jetësore dhe muzikore të të riut Uran Bajrami, anëtar i bendit prishtinas "Babilon".

"Somewhere near my house" (Diku pranë shtëpisë sime) është film i metrazhit të shkurtë, i bazuar në rrëfimin mbi Uranin dhe "Babilonin". Agim F. Gërbeshi - njëkohësisht skenarist dhe regjisor, producent dhe njëri ndër bartësit e rolit kryesor në filmin 12-minutash të xhiruar në New York të SHBA - tentoi ta portretizojë rrugën muzikore të "Babilonit", njërit ndër rok-bendet e skenës kosovare të viteve '80 dhe të Uran Bajramit, bas-kitaristit të "Babilonasve" i cili tragjikisht humbi jetën në aksident trafiku më 1989. të gjithë ata që kishin dhe që do të kenë rastin ta shohin këtë film, gjithsesi do t'i vërejnë mangësitë e një produksioni

me buxhet të vogël - natyrisht, krahasuar me standardet amerikane. Përveç spicës paralajmëruese të përcjellë me "Shine On You Crazy Diamond" nga "Pink Floyd", në të cilën figurojnë emrat e aktorëve shqiptarë: Agim B. Gërbeshi (Urani), Agim F. Gërbeshi (Poqi), Elvin Shehu (Keksi), Ragip F. Gërbeshi (Besi) dhe të pjesëtarëve amerikanë të ekipit, dhe e cila me pompozitet jep shenjë për një film të rangut të lartë, asgjë tjetër nuk impresionon. I tërë realizimi duket sikur të ishte i përbërë nga fragmentet e një filmi me metrazh të gjatë, montazhi i të cilave është bërë shpejt dhe jo me kujdes të theksuar. Për ata që nuk e dinë ngjarjen e vërtetë - e që shërbeu skenar për film - vështirë se do të kuptonin çfarë ndodhi në të vërtetë. Tutje, vetë aktrimi është i nivelit amator. Skenari i "Somëhere..." është tentim i amerikanizimit të një rrëfimi kosovar dhe kjo u realizua në mënyrë mjaft sipërfaqësore. Megjithatë, "Somwhere Near My House" vlen të shikohet, nëse jo për diç tjetër, atëherë si kujtim për entuziazmin dhe tragjedinë e Uran Bajramit.

autor A. Bajrami

Ndërsa në Koha Ditore, e datës 16 maj 1997, gjejmë këtë shkrim:

R O K

Mbrëmje filmi dhe R'N'R' në Casablanka
Film për një roker shqiptar

Autorët dhe grupet më të njohura kosovare marrin pjesë në një mbrëmje hepeningu në lavd të rokut kosovar të viteve '80-të, për ta madhëruar premierën kosovare të filmit SOMWHERE NEAR MY HOUSE të regjisorit shqiptar që jeton në Amerikë, Agim F. Gërbeshi. Filmi debi i regjisorit Gërbeshi i kushtohet fatit tragjik të URAN BAJRAMIT, rokerit që vdiq tragjikisht, në rrugë e sipër për të blerë një kitarë.

Të dielën në diskon "Kasablanka", duke filluar nga ora 21,00, do të mbahet një samit i vërtetë i rokerëve kosovarë që do të mblidhen për të madhëruar premierën kosovare të filmit debi të regjisorit Agim Gërbeshi. Regjisori Gërbeshi ka vite që jeton në Amerikë. Ka mbaruar në Nju Jork Akademi of Film dhe filmi i tij debi i metrazhit të shkurtër i dedikohet rokut kosovar të viteve '80-ta, gjegjësisht fatit tragjik të Uran Bajramit, njërit nga rokerët e grupit "Babilon" që humbi jetën tragjikisht në një aksident komunikacioni. Qe nisur për të blerë një kitarë në Bullgari. Filmi mban titullin e një kënge

të këtij grupi autor i së cilës ishte vetë Urani i ndjerë e në të cilën sikur parandihet vdekja. Kënga, sipas regjisorit të filmit, ishte njëfarë omeni që alarmonte, grishte, sinjalizonte. Por, sikur e citon Markesin regjisori Gërbeshi, vdekja është e pashmangshme, mu si te ajo kronika e famshme e një vdekje të paralajmëruar. "Somwhere near my Mouse" (Diku pranë shtëpisë sime) është titulli i filmit dhe i këngës në të cilën thuhet:... vitet kaluan sikur disa çaste / dielli shumë shpejt perëndoi / diku pranë shtëpisë sime / çdo gjë mbaroi... Duke e nderuar jo vetëm kujtimin e Uranit, por edhe duke kujtuar njëherësh edhe vitet e arta të rokut kosovar, vitet '80-ta, në Kasablanka kanë paralajmëruar një samit të vërtetë të gjithë rokerët kosovarë: Naser Gjinovci dhe Minatori, Nexhat Macula dhe TNT, ODA, Ilir Bajri, Poçi, Geza, Enis Presheva, LINDJA, Luli, MARIGONA, Violeta Rexhepagiq, Iliriana Loxha, Shenolli, Anita Vukpalaj, Jericho Wals, Game Over, Beka, FORTUNA, Asgjë sikur dielli... Fjalën e rastit do ta mbajë Migjen Kelmendi. Udhëheqës i mbrëmjes do të jetë Lekë Zherka.

P.S. Manifestimi është mbajtur të dielën më 18 maj 1997 në orën 21,00.

Në një intervistë të B. B. Poqit, realizuar nga Halim Muçolli në gazetën e studentëve "Bota e re" në kornizë, përkujtohet Urani. Pos shkrimit për të, është edhe fotoja dhe vjersha e tij "Diku në afërsi të shtëpisë sime".

Titulli i këtij përkushtimi është:

"Diku pranë shtëpisë sime" – këngë vetëpërkushtimi[2]

Para një muaji u bënë plot gjashtë vite nga vdekja tragjike e Uran Bajramit, ish-anëtarit të rok-grupit "Babilon". Adhuruesit e rokut në Kosovë, për shumëçka do të kenë pse të kujtojnë djaloshin e dashuruar në muzikë, prej së cilës u nda në kohën kur mund të jepte më së shumti. I rritur në një familje të arsimuar, si i ri filloi të bëjë muzikë, për ta formuar me shokët e vet rok-grupin "Babilon", me të cilin arritën suksese, duke incizuar madje edhe në RTP. Në moshën 21 vjeçare sa priste të fillonte vitin e dytë në Fakultetin Ekonomik, vdekja tragjike e rrëmbeu nga ëndrrat studentore, kënga, familja, shoqëria, planet... Sot edhe pas gjashtë (6) vitesh, shokët e grupit e kujtojnë me pietet, pa harruar të deshifrojnë simbolikën e këngës së fundit "Diku pranë shtëpisë sime" – autor-teksti i së cilës ishte i ndjeri Uran. Kjo edhe u bë përkushtim ndaj Uranit, i

[2] Halim Muçolli: "Bota e re" nëntor 1995

cili edhe në këtë formë shprehte parandjenjën e vdekjes.

Panorama dhe njoftimi i Agim F. Gërbeshit për filmin

Në këtë panoramë të adresuar B. B. Poqit, regjisori i filmit "Somwhere near my house", njofton Poqin që kishte përfunduar filmin e nisur për jetën e kitaristit dhe tekst-shkruesit të këngëve dhe anëtarit të bendit "Babilon" Uran Bajrami, i cili ishte nisur për në Bullgari për të blerë një kitarë elektrike e nuk u kthye i gjallë në shtëpi. Fati deshi që, jeta e tij të zbarkonte rrugës për në Prishtinë, sepse, në kthim e sipër nga ai udhëtim i papërfunduar, ndodh një aksident komunikacioni dhe Uran Bajrami së bashku me shokun e fëmijërisë dhe të lagjes ku ishin rritur, Pajtim Kapitin dhe të fejuarën e ardhshme të këtij të dytit, humbën jetën tragjikisht në 30 shtatorin e vitit 1989.

Në panoramën dërguar B.B. Poqit, ku duken katër anëtarët e Bendit "Babilon" (aktorët) duke ecur rrugëve të një qyteti, e që njëherësh është edhe pano njoftimi për shfaqjen e filmit shkruan:

AGIM F. GËRBESHI
prezanton

SOMWHERE NEAR MY HOUSE
Bazuar në ngjarje të vërtetë,

shkruar, edituar dhe regjia
nga Agim F. Gërbeshi
dhe MAGNO SOUND & VIDEO

729 Seventh Avenue
(në afërsi të rrugës 49) New York City, NY 10019

E enjte, 14 Nëntor, 1996
Me fillim në orën 4:30 & 5:00 PM,
film dymbëdhjetë minutash.

Ndërkaq në anën e pasme një njoftim i shkurtë që i bën regjisori Agim F. Gërbeshi, anëtarit të bendit "Babilon" B. B. Poçit, rolin e të cilit e kishte luajtur vetë regjisori Gërbeshi. Ky njoftim ka këtë përmbajtje:

Tung Poqi

Ky film filloi dhe përfundoi. "Diku pranë shtëpisë sime" në USA. Bisedat në telefon dhe letrat më ndihmuan shumë që ta bëj karakterin tënd sa më real. Shumë të fala nga Agim F. Gërbeshi - Poqi.

P.S. O Babilon ëndrrat do t'jetojnë gjithmonë...

SOMWHERE NEAR MY HOUSE

(DIKU PRANË SHTËPISË SIME)

regjia, skenari dhe producent
AGIM F. GËRBESHI

organizon
B.B. POQI, GEZA,
FALI, SHENOLLI dhe

UDHËHEQËS I HORËNJËS: - LEKË ZHERKA
HIGJEN KELHENDI - FJALA E RASTIT

mysafirët:
TNT, MINATORI, LINDJA, MARIGONA, ODA, ILIR BAJRI, ENIS PRESHEVA, LULI, XHEVDET GASHI, ASGJË SIKUR DIELLI, ARMEND XHAFERI-XHAFA, JERICHO WALLS, GAME OVER, M.C. BEKA

CASABLANCA
E Diellë / 18. 05. '97
Në ora 21^{00}h

KRIJIME LETRARE KUSHTUAR URAN BAJRAMIT

Venera Bajrami

PELLGU I DHEMBJES

(Prozë poetike, kushtuar Uranit)

E fundosur në pellgun e dhembjes shpaloj kujtimet për ty. Sa i ëmbël është ai kujtim. Mu si fytyra jote e qetë dhe e ndritshme. Po, kujtimi i datës 30 shtator 1989, kur agimi i asaj dite solli perëndimin e ëndrrave tona, vëlla. Solli perëndimin e gëzimeve të mia dhe i rrënjosi në thellësinë e shpirtit tim. I mbuloi me dhembje dhe mall të pashuar për ty. Athua cila fuqi të shkëputi trishtueshëm nga ëndrrat tona rinore?

Cila dorë ta ndali hovin e rrugës sate të lavdishme?

Cila tingëllimë të tmerroi ta vazhdosh këngën tënde të pambaruar?

Po. Pikërisht, atë ditë, ra një yll nga qielli. Një dritë u shua përjetë. Një këngë mbeti e pambaruar dhe një tingull kitare humbi ritmin e saj duke rënkuar pa artikulueshëm dhe u rrokullis në hapësirë të pafund pikëllimi.

Mbi fytyrën tënde nur, që ëndërrova atë ditë, vështrova buzëqeshjen e ngrysur në buzët tua të trëndafilta dhe mendova: ***vallë edhe vdekja t'u duk e ëmbël?***

T'i vëreja qepallat e palosura sikur t'i kishte palosur një dorë arkitekti. Ato frikësoheshin nga unë

e qëndronin aq afër si të ishin rojet e dy syve të kristaltë, dy livadheve të bleruara që u mbyllën për jetë.

Ta shikoja në vetull krenarinë e përjetshme dhe mendoja: ***I tillë u linde, i tillë mbete***.

Në korridorin e tymosur trokita në ora tre. M'u duk se të kishte kaluar koha e gjumit. Një fllad i vogël më galdoi zemrën dhe thashë: ***- Tani do të zgjohet***. Por, nuk pashë as përpëlitjen më të vogël të qepallave tua. Nuk dëgjova as tingëllimën më të lehtë të buzëve të pushuara. Atëherë, me padurim, por edhe me frikë të madhe t'u luta që të zgjohesh, se është koha të bëjmë një dasmë të madhe. Kishim aq shumë krushq si askush më parë. E ti, kësaj here s'më dëgjove dhe u pajtove ta kalosh edhe pragun e shtëpisë aq të dashur për ty.

Si pate zemër ta lësh nënën e babin?

Si munde t'ua prishësh qejfin atyre kur ata kurrë s'ta kishin prishur ty?

Nuk u zgjove as atëherë kur toka e zezë të mbulonte.

Si u pajtove me vetminë kur gjithmonë e urreje?

Shikoja trishtueshëm atë copë tokë. Më bëhej sikur krenohej dhe ai vend dukej madhështor e sikur më thoshte: ***Unë fitova!***

U largova nga varrezat kokulur e kthyer me kokë nga ti, dhe sa bëja një hap më kaplonte dëshira të kthehem. Por, për një moment ndjeva se humba

shumë çka në jetën time. ***Vallë, si më le të të humb kur ne të dy gjithmonë kemi jetuar?***

Rreth vetes pashë një turmë të madhe njerëzish duke qëndruar nën qiellin e ngrysur. Sytë e tyre nuk lotonin por thellë brendinë e tyre shihej një ndjenë dhembjeje për ty.

Urani, Venera, Esma e Arben Xheladini

Atëherë u binda, se, nuk kisha humbur vetëm unë, kishin humbur shumë njerëz nga një pjesë të tyre.

Dy prindërit kishin humbur shpresën e jetës. Kishin humbur yllin më të ndritshëm. Shumë të rinj, shokun e jetës. Shumë të reja adhurimin…

Unë kisha humbur të gjitha. Edhe zemrën që kisha një me tënden.

Sonte, me një dhembje më shumë në zemër, po qëndroj në dhomën tënde. Shikoj përtej dritares dhe kërkoj e humbur në errësirë një dorë që më iku pa e ndier. Një lumë që vërshoi dhe nuk kthehej në shtratin e tij.

Eja!

Nuk dua t'i kaloj netët e gjata e vetmuar.

Dua të hyjmë bashkë në botën e pafund të diturisë.

Të flemë pranë njëri-tjetrit sikur ishim të vegjël.

Ta dëgjojmë këngën tonë së bashku.

Eja!

Dua të shërohem me tingujt e kitarës sate.

Eja!

Të më tregosh si fliste Zaratustra.

Eja!

Mos lejo që në rrudhat e babait të farkohet dhembja për ty.

Eja!

T'ia fshish lotët nënës me dorën tënde.

Eja!

…se në arteriet e tyre nuk qarkullon më gjaku, por zjarri e malli i pashuar për ty.

Nëse mund të më dëgjosh: ***eja të paktën të më tregosh si ta vazhdoj jetën pa ty,***

Uran - pellg i dhembjes!!!?

Jonuz FETAHAJ

KULLA E BABILONIT

- Uran Bajramit -

Një mijë e një net ëndërruam
E gjumin s'e futëm në sy,
Kullën e Babilonit e mësuam
Si përrallën e gjyshes unë e ti

E ia thamë një kënge të re
Të moçme sa e tërë jeta
E s'u ngopëm as me fjalë
As me shikim kah e vërteta

E kishim pranverë n'zemër
Zemrën e kishim plot dashuri
Shpirtit tonë i dhamë udhë
Me tingull kitare ike ti...

Kurrë nuk ëndërrove ngjyrëverdhën
Të përhimëtën e përzjeve me dhembje
Rigat e shiut i fute në pentagram
U mallin me nota t'vetmisë derdhe

Syhejl HAVOLLI

I RA MORTAJA FJALËS

Kush tha se dhembja është
Më e madhe se Kulla e Babilonit
Pati të drejtë të pështillet
Me dhembjen e shpirtit

E shkurt dhe e gjatë jeta
Çfarë udhëtimi bëhet nuk dihet
Orës i ra lia
Nuk matet më as dita e koha

Gjithçka është përzier mallshëm
Në këtë rrugëtim vetmitar

E kafshojmë vetëm kujtimin tinëzisht
E zbardhemi si borë dimri
Në shpirt e lavër balli, Uran

Urtësisht mbjellim kujtesën
Në hullinë e fjalëve të mallëngjimit

MBRËMË

Prej pranverës plot pikëllim
mbrëmë u takova me Uranin
te bregu i harrimit
dhe biseduam gjerë e gjatë
për dhembjen e Kosovës

ikëm prej bregut të harrimit
për të vazhduar rrugën
kah bregu i amshimit

nën hijet e shelgjeve të pikëlluara
në rrasë të gurit një emër
i gdhendur nëpër shekuj
nëpër ballë na binte dritë
për të parë njëri-tjetrin pa pikëllim

derisa mua më dridhej buza
Urani merrte shënime tinëzisht
për t'i kompozuar në këngë

ai iku nëpër buzëqeshje
shpat më shpat – vetëtimë

ç'më shtyri të ëndërroj
për ikjen e tij plot mall

Urani para shtëpisë së vet

KITARISTI NUK ËSHTË

O kënga ime, je ndalur në breg
Je ngujuar pa dashje në harkoj
Kitaristi nuk është – ajo ka vdekur

Rininë e lidhi në lakimet e rrugëve
Në vrushkujt e kohës shtatin thatanik rriti
O kënga ime – o vargu im
Për kitaristin e shpirtit ç'të them?

Mallin e pat fshehur në lojën e lodhur
Durimin e pat ëndërrim
Më afër se bebëzën e syrit
Kitaristi nuk është më – ai ka vdekur!

O kënga ime, o vargu im i këputur
Atje në errësirën e varrit
Pse i palove kujtimet e nisjes?
Derisa ne ecim nëpër shi drejt syve të tu.

Në dhomën e zemrës çdo ditë të kërkoj
E zemra e fjalës sime është e vogël
Sa të zërë shpirtin tënd të madh.

LUMI I DHEMBJES

Zgjohu që ta shqelmosh vdekjen Uran
është koha t'i djegim shamizezat e vajtimit
të ngremë piramidë gëzimesh deri në qiell
ta pikturojmë jetën ta mbëltojmë farën e durimit
diellin ta ndalim që kurrë të mos perëndojë

sypërlotur shikoj portretin tënd të varur në mur
nëpër shtratin e zemrës ngushëllimi më rrjedh si lumë

buzëqeshjet që ta kënaqnin zemrën tënde zambak
Donika duarshtrira te pragu i derës pret përqafimin
Lavoni krahthyer shikon përtej dritares zemërdjegur
nëna me një thirrje më pak s'mashtrohet kurrë për jetë

sonte ku mund të gjej ilaç për ta kthyer hapërimin prapë
të dalim nëpër ato fusha të thithim aromën e luleve
ç'mbeti më e rëndë se ajo fjalë se ai gur mbi kokë
ti Lumë i Dhembjes Buzëqeshje e tepruar kurrë në vatër.

O shpirt filiz në kopshtin e dhembjes sime
gjethet e shelgjeve të mërrola më ngushëllojnë mua
dhe në të njëjtën hije mbulon edhe atë që e dua
o natë e dhembjes sime afro trupat tonë në ëndrra

mot për mot pres trupin tënd të vijë si në ëndërr
dhe nga lart zbriti vetëm një yll dhe u ul pranë meje
vaji në buzë nuk i ndalej si për Ty si për Ne – medet.

Izet HAJDINI

YLLIT UNIKAT

I vdekuri me të vdekurin
i gjalli me të gjallë
ligjet e natyrës
askush s'mund t'i ndal.

Donika, Venera
t'zi e kanë fustanin
sa herë hapet dera
mendojnë për Uranin

Raifi e Urani
ishin babë e bir
shumë zemra dardani
me pikëllim u ndanë.

Shumë u mërzit Besimi
e shokët e tjerë...
i kaploi pikëllimi
për mikun e ndjerë.

Pa u përshëndetur
me prind e vëllazëri
ndërroi jetë tjetër
shkoi në përjetësi.

Ka pasur respekt
në familje, në shoqëri...
si i lë krejt vetë
si t'rrojnë prindërit pa ty.

Ishe i dalluar
në sjellje, në edukatë
kurrë s'do të harrojnë
o yll unikat

autori është i ati i Besim Hajdinit

P.S. Janë këto punime kushtuar Uranit. "Pellgu i dhembjes" është një prozë poetike e Venera Bajramit. (e motra e Uranit) Një poezi e Jonuz Fetahajt, katër poezi të poetit Suhejl Havolli që ia kushtoi Uran Bajramit, për miqësinë e vjetër që kishte dhe ka me të atin e tij, Raif Bajramin. Mbase në këtë mënyrë sado pak deshi t'i zbuste dhembjen mikut tij të vjetër. Dhe një poezi e Izet Hajdinit, të atit të Besimit (mik i fëmijërisë i Uranit).

ALBUM FOTOGRAFISH

Urani i vogël

Urani me prindërit në Bullgari

Urani me nënën

Urani me babanë



Urani me babanë, Lavonin dhe Urimin

Urani me nënën, gjyshen dhe motrën

Urani me kusheririn Selamiun

Urani, Venera dhe...

Urani duke pirë kafe

Urani duke ekzektuar në çifteli, fotografuar në Bregun e Diellit

Urani duke performuar me kokë

Urani, Bekimi, Besimi, Luli

Urani me shokë dhe kujdestarin e klasës

Urani me familjen e gjerë...



Nga e djathta: Urani, Hatabi, Gjini dhe Genci

Urani në vendlindjen e babait, Corroticë (Preshevë)



Urani dhe Pajtim Kapiti



Urani dhe Arianit Alaj



Urani para Fakulteti Filologjik



Urani në Bullgari



BALADA PËR ...

SONTE HESHT QYTETI
SHIU DO TË FOLOJË,
KËRKOJ SHIKIMIN E SAJË
NË ERRËSIRË,
QIETET RRUGËS KALOJNË
MË HARRIN PËR TË HARRË
NATA MË KUJTON GËZIMET DHE
DASHURINË E PARË.

ÇASTET MË DUKEN SHEKUJ
NATA MË ËSHTË E GJATË PA TY,
FËMIJËRINË MA MORËN ËNDËRRAT
E ËNDËRRAT MI MORRE TI,
LARG FRYEJNË ERËRAT
BARTIN
~~HARRIN~~ PLUHURIN ...
TI SHKOVE POR ...

Ref.:

TI JE VET...
DHE ASGJË M...
TI JE NJË ...
A TË ...

SONTE BREDHE...
SHTEGËTARËT ...
MUNDOHEM TI ...
POR NUK I ...
TRENI I MESA...
FYTYRA TË RE...
QYTETI HUJ...
E TASH MË ...

Faksimil nga dorëshkrimi i tij

B.B.Poqi

Në Amerikë u xhirua filmi i metrazhit të shkurtër për "Babilonin"

"SOMEWERE NEAR MY HOUSE"

Fakt është se njëra ndër fytyrat më të ndritura të rock - muzikës kosovare është Bajram Bylykbashi, i njohur me emrin B.B.Poqi. Pas një tragjedie që pat grupi BABILON, ku në një ndeshje komunikacioni vdiq anëtari i grupit, Besimi lëshoi atdheun dhe kështu si plot grupe të tjera edhe BABILONI e ndali hovin e tij. Mirëpo, Poqi me punën e tij dhe mundin që bëri gjatë tërë kohës kur rock - muzika kishte nevojë të kultivohej, ai e ruajti nivelin dhe karakterin e saj dhe mu për këtë arriti të bëhet ky që është sot, B.B.Poqi.

Flasin të gjithë për fillimin tënd, çka flet ti?

Poqi: Dihet mirë se me një fillim të këtillë, siç fillova unë, nuk është lehtë të afirmohet gjithkush. Në atë kohë kur të gjithë rokerët pa dallim bënin tezga për shkaqe materiale, mua nuk më pëlqente kjo punë, fillova me një kitarë akustike të mbaja rok mbrëmje dhe në ato mbrëmje ndihej mungesa e rokut. Kështu duke u shtuar kërkesa dhe interpretimi im publiku gjithmonë kthehej kah ajo që ishte dikur. Më vonë arrita t'i bëja instrumentet profesionale e gjithashtu edhe një "bend" ku gjenden persona profesionalë të stilit rock - roll.

Kush janë anëtarët e rinj dhe ku u prezentuat së pari?

Poqi: Anëtarët e rinj janë Gëzim Hasku-Geza, solokitarist e gjithashtu edhe sintizajserist, i cili është profesionist dhe ka sound - instrumente të cilësisë së lartë, pastaj është Shenoll Muharremi ish - basisti i "Marigonës" dhe Fahri Ibrahimi-Fali - daulle. Të gjithë anëtarët janë profesionistë dhe i kontribuojnë rokut pa kurrfar interesi materialist, duke u munduar ta çojmë rokun përpara. Me këtë preformansë së pari u prezentuam në motelin "Beni" në mbrëmjen "miss - party".

Në cilat vende mbajtët koncerte ?

Poqi: Dihet se ne jemi grupi i cili bartë me vehte ndoshta edhe rekordin e koncerteve në Kosovë, mbajtëm koncerte në Pejë, Suharekë, Mitrovicë, Prishtinë. Po me këtë përbërje ishim edhe në Maqedoni, si në: Shkup, Tetovë, Dibër, e që si mysafirë kishim grupin TNT. Në Maqedoni nuk e besonim se ishim aq të njohur te publiku, ata së bashku na përcillnin dhe i dinin mirë këngët e "Babilonit", po ashtu edhe këngët e albumit "Ndoshta me një blues". Në këto qytete interpretuam edhe këngë të "Telex-ave". Gjithashtu, kemi bërë edhe ndryshime në repertuar, duke interpretuar këngë të reja të cilat publiku mirë i priti.

Thuhet se je i afërt dhe komunikativ me të rinjtë?

Poqi: Unë gjithmonë, duke shikuar vehten dhe duke ditur se si shkojnë punët kam afruar të rinjtë të cilët janë talentë. Gjithashtu, në albumin e parë kanë qenë mysafirë tre kitaristë të rinjë. Një kohësisht kam qenë edhe organizator kryesor i ROCK TRIBUNËS që u mbajt në Prishtinë, por tërë ai mund që bëra pa falënderime i shkoi forumit rinor të LDK-së.

A keni përgatitur diçka për festivalin pranveror?

Poqi : Në festivalin pranveror konkuruam dhe u pranua kënga e parë e albumit të ri "S'dua të besoj".

Kur do të dalë albumi i ri?

Poqi : Albumi i ri do të del në emër të B.B.Poqi&Geza kah fundi i qershorit. Albumi do të jetë i stilit rok modern e jo atij klasik, përkatësisht do të jenë 10 këngë që janë të zgjedhura prej më shumë se 20 komponimeve që i bëmë unë dhe Geza.

Ç'është aktuale për ju?

Poqi: Një gjë që mua më tronditi e gjithashtu edhe juve është se për "Babilonin" në Amerikë është botuar edhe një film i metrazhit të shkurtër, i cili titullohet me emrin "SOMEWERE NEAR MY HOUSE" në bazë të këngës "DIKU PRANË SHTËPISË SIME", e cila mbeti legjendë e rokut kosovar e gjithashtu edhe e "Babilonit". Ky është filmi i parë në mbarë botën shqiptare i cili u inçizua ndonjëherë për ndonjë grup rock&roll duke iu falënderuar regjisorit Agim F.Gërbeshi, i cili akademinë e regjisë e mbaroi në New York.

Filmi zgjati 12 min., është njëkohësisht i tipit me cilësi të lartë. Filmi i është kushtuar tragjedisë së grupit "Babilon" dhe ngjarjes së vërtetë për të ndjerin Uran R. Bajrami, i cili si muzikant i ri shqiptar nga Kosova shkoi në Bullgari për të blerë një kitarë dhe nuk u kthye më kurrë. Në film shihet qartë edhe përkthimi në gjuhën angleze të këngës "Diku pranë shtëpisë sime", tekstin e së cilës e shkroi i ndjeri Uran R. Bajrami.

Bisedën e zhvilloi Astrit D.

12

Faksimil nga revista "Kosovarja"



Bendi "Babilon"

Kitara "Melodia me të cilën ekzekutonte Urani"



Urani prapa veturës...

Kortezhi...

Varri i Uran Bajramit

URÁN

Kur pritnim këngën skofiare nga buzët e tua dhe që sot së bashku të festojmë ditëlindjen tënde, ne na mbushen gotat me lot pikëllimi se të humbëm shumë herët.

Shokët: Dukagjini, Genci dhe Arianiti (2.09.90)

PËRMBAJTJA

Në vend të parathënies 5

BIOGRAFIA E URAN BAJRAMIT 7

NJË HISTORIK I SHKURTËR I BENDIT BABILON 12

PËR URANIN FOLËN... 15

KRIJIME (POEZI TË BOTUARA)
NGA URAN BAJRAMI.....41

KRIJIME (POEZI) TË PABOTUARA 59

SHKRIME NËPËR GAZETA PËR URAN BAJRAMIN
DHE VEPRIMTARINË E TIJ MUZIKORE.....81

KRIJIME LETRARE KUSHTUAR URAN BAJRAMIT 91

ALBUM FOTOGRAFISH 105

FERID SELIMI
JONUZ FETAHAJ

PELLGU I DHEMBJES
(Monografi për Uran Bajramin)

Realizimi kompjuterik
Valon J. Fetahu
Prishtinë

U shtyp në shtypshkronjën
GRAFOPRINT
Prishtinë

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës